

# PENSIONET E VJETRA, JA KUR DO T'I MARRIN LEKET TE MOSHUARIT

ISSH: Nga muaj maj të moshuarit do të marrin lekët. Shtesa deri në 5200 lekë në muaj



**Kriza është ligjërimore**

Personalisht nuk kam pasur asnjë dyshim që kriza politike në të cilën është përfshirë Shqipëria, është një spektakël banal, pa asnjë përmbajtje, është një krizë që gjendet në vetëdijen e ndrydhur politike të Sali Berishës dhe pastaj imitohet në mënyrë karikaturore nga Lulëzim Basha.

vijon në faqen 6

# [SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 82

E DIEL, 09-04-2017

www.shqiptarja.com

## ATENTATI MAFIOZ

### TIRANE, VRITET ISH-ZYRTARI I LARTE I POLICISE ARTAN CUKU



Artan Cuku është ekzekutuar me armë zjarri nga dy persona në hyrje të pallatit ku banonte pranë Liqenit Artificial. Pistat e hetimeve

F11

## MAGAZINA E KANABISIT



### REKORD, KAPEN 12 TON DROGE NE PERMET

Policia zbulon një magazinë në fshatin Pagri të tejmbushur me kanabis

F9



## REGJISTRIMI NE ZGJEDHJE

# SHTYHET AFATI EDHE 19 DITE KOHE PER DIALOG

Nesër skadon afati zyrtar, por opozitës do t'i jepet kohë deri në 29 prill. Denar Biba: Vota ime pro edhe pas datës 10 prill. Deri tani janë regjistruar, veç PS dhe LSI, 31 parti në zgjedhje, marrin pjesë edhe grekët e MEGA-s, partia e Bojaxhiut dhe Ngjela

F4-5



## SUPLEMENTI "RILINDASI"

### DEBATI BUTAFORIK PER ÇESHTJEN E FILMAVE SHQIPTARE, A DUHEN NDALUAR

Cila është e vërteta rreth kësaj pasurie të madhe të artit filmor të Shqipërisë

NGA DR. MOIKOM ZEKO



### ELBASANI I SHEK. XVII, "NUSJA E SHQIPERISE DHE E RUMELISE"

NGA EDUART ÇAKA

### DITARI I MINISTRIT AMERIKAN NE SHQIPERIN E PRINC VIDIT

F13-20



# Rama thumbon Bashën: Çfarë është qeveria, hotel Rozafa?

Kryeministri: Ngujimi në atë çadër vjen prej frikës nga drejtësia, me 18 qershor të rinjtë të votojnë për çlirimin e gjyqësorit

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Kryeministri Edi Rama duket i vendosur për të mos i hapë rrugë krijimit të një qeverie teknike dhe shtyrjes së zgjedhjeve. Madje, nga Shkodra, gjatë një takimi me të rinjtë që votojnë për herë të parë, Rama ka ironizuar partitë politike që kërkojnë qeveri teknike apo ndryshimin e qeverisë. Duke shigjetuar kryetarin e opozitës, por edhe aktorë të tjerë të politikës, Rama tha se qeveria nuk është Hotel Rozafa. Rama ka ironizuar edhe argumentin se opozitës, sipas të cilës kauza e saj nuk ka të bëjë me çështje karrigesh. “E keni dëgjuar që thonë hajde ikim ne dhe të vijmë këta. Po pse çfarë është qeveria Hotel Rozafa? Po kur thonë nuk është çështje karrigesh? Të jesh kryeministër i vendit nuk është se je i privilegjuar sepse ke suitën e hotel ‘Rozafës’ dhe tani thonë: Dël nga suita të futen dhe këta të bëjnë një dush se kanë 50 ditë në çadër”, tha Rama.

## FRIKA NGA DREJTËSIA

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje se ngujimi në çadër është reflektim i frikës nga drejtësia. “Zgjedhjet e 18 qershorit nuk janë zgjedhje mes partive, por mes Shqipërisë që kishim dhe asaj që duam. Shqipëria që kishim sot është e ngujuar në një çadër mes Bulevardit. Ju e dini mirë kush ngujohet ka një arsye për t’u fshehur. Kush ngujohet ka një motiv shumë të fortë për të refuzuar



## RAMA

“E keni dëgjuar që thonë hajde ikim ne dhe të vijmë këta. Po pse çfarë është qeveria Hotel Rozafa? Po kur thonë nuk është çështje karrigesh? Të jesh kryeministër i vendit nuk është se je i privilegjuar sepse ke suitën e hotel ‘Rozafës’”.

të ballafaqohet me njerëzit. Ngujimi në atë çadër është ngujimi që vjen prej një frike shumë të madhe. Frika nga drejtësia. Motiv ynë për të shkuar në zgjedhje me 18 qershor dhe për t’u kërkuar të rinjtë të votojnë është çlirimi i drejtësisë”, tha Rama. Kryeministri u ndal edhe tek

rëndësia e zgjedhjeve. “Të gjithë janë të nevojshëm, por jo të gjithë mund ta kuptojnë rëndësinë themelore të kësaj date dhe rëndësinë e vendimit që do merret, siç e kuptojnë të rinjtë dhe gratë. Gratë e dinë shumë mirë si mbahet një shtëpi dhe se çfarë e rrezikon atë. Ato punojnë për një shtëpi sepse burrat shqiptarë po nuk patën gratë ngelen rrugëve dhe s’i prek kush me dorë. E ka thënë Çajupi “Burrat nën hije lozin kuvendojnë, pika që s’u bie se nga gratë rrojnë”, është shprehur ai.

## APELI PËR TË RINJ

Rama u fokusua tek arsyet se përse shkodranët duhet të votojnë Partinë Socialiste. “Këta të çadërës kanë një problem, po nuk shkuan të hanë themelet nuk rrinë dot, më

## SHKODËR / KRYEMINISTRI PËRPLASET ME VOLTANA ADEMIN

# Rama: Ura e Bunës e harruar. Kryebashkiakja: Autogol

Nuk reshtin përplasjet mes kryeministrit Edi Rama dhe kryebashkiakes së Shkodrës, Voltana Ademi. Vizita e kryeministrit në Shkodër është shoqëruar me ngacmime dhe replika mes tij kryebashkiakes Voltana Ademi. Shkak është bërë Ura e Bunës që sipas Ramës është lënë në mëshirë të fatit me qëllim nga kryebashkiakja. “Jam rrugës për Shkodër, kemi takim me votuesit për herë të parë. Shkodrën e kam dashuri të vjetër sa jeta e kujtimi i gjyshe sime dhe dhimbje, sepse s’po mundemi dot të bëjmë sa meriton. Kjo është Ura e Bunës dhe i lutem

çdo shkodrani që e sheh, t’ia çojë këtë pamje të trishtueshme kryebashkiakes dhe t’i thotë se nuk duhen lekë, po mjaftojnë sytë e dashurisë për Shkodrën, për ta riparuar brenda muajit! Veç mos i thoni që ju thashë unë, se e shkreta Voltanë mendon se sa më shumë të rrënohet Shkodra, aq më shumë do t’i urrejë socialistët. VajmedetpërShkodrën”, ka shkruar Rama. Por zonja Ademi jo vetëm që nuk e ka mirëpritur këtë kritikë, por e ka ftuar Ramën dhe të kandidojë përballë saj në Shkodër e që ky i fundit të përdorë fuqinë e PS përballë saj. “Kryeministër, sa herë

## PËRPLASJA

Vizita e kryeministrit në Shkodër është shoqëruar me ngacmime dhe replika mes tij kryebashkiakes Voltana Ademi. Shkak është bërë Ura e Bunës që sipas Ramës është lënë në mëshirë të fatit me qëllim nga kryebashkiakja.

flet për Shkodrën ti bën autogol! Shumë komode të të kem ty kundërshtar politik. Edhe një grusht njerëzish socialist që të kanë mbetur në Shkodër e dinë se Ura e Bunës është pronë e Ministrisë së Mbrojtjes. Ju vetë, qëllimisht po tentoni të shkatërroni Shkodrën,

por nuk ia dolën asnjë, as komunizmi! E këtë lojë e kanë kuptuar të gjithë. Sa për transparencë, po publikoj shkresën që i kemi dërguar Ministrisë dhe u kemi thënë që po kontribuojmë me fonde, por ato kanë heshtur, sepse duhet që ti të bësh foto! Nëse ke dashuri për Shkodrën

kështu do më gësh dhe pas 5 vitesh kur të vish”, tha Rama.

## PËR VOLTANA ADEMIN

Kryeministri ka shigjetuar edhe kryebashkiaken e Shkodrës, Voltana Ademin. “Por kryebashkiaku aty (Tropojë) me vërtet është demokrat, nuk do të më shohë me sy, por më takon, me jep dorën dhe më dëgjon për projektet për Tropojën. Shkoni shkoni Tropojën tani! Shko shiko Tamarën, moj zonja kryebashkiake. Nuk duam sheshe thotë, nuk duam se nuk kemi bukë të hamë. Këtyre sikur ju ha

atëherë, mos e shkatërro siç po bën për hakmarrje politike. Dhe nëse ke dëshirë të drejtosh Shkodrën në qofsh burrë, hajde pas dy vitesh, konkurro këtu në Shkodër përballë meje! Faleminderit që ekziston Edi Rama”, tha Ademi. Por, Rama e ka shigjetuar sërish Ademin, duke i treguar se është i njëjti shembull si Basha që sipas tij, nuk bëri asnjë gjë për Tiranën. “Voltana, ti në Bashkinë e Shkodrës nuk bën asgjë më shumë se sa ç’bëri Lulëzimi në Bashkinë e Tiranës, d.m.th vetëm fle, dhe në jetë nuk bën asgjë më shumë se sa ç’bën Lulëzimi në çadër, d.m.th flet

po nuk mban përgjegjësi për çfarë thua! Po njësoj si Lulëzimi, ti i jep shumë rëndësi vetes duke menduar se unë jam kundërshtari yt. Por në fakt unë jam thjesht kundërshtari i dembelëve që u punon gjuha jo truri, i parazitëve që u punon goja jo zemra, i karagjozëve që u punon djallëzia jo qytetaria. Nuk e di nëse ti hyj në këto kategori, që kanë populluar politikën shqiptare prej çerekshekulli e këtej, sepse realisht, s’të kam parë ndonjëherë me këtë sy. Por di me siguri që mes Shkodrës e teje, ka po aq lidhje sa ç’kishte mes Lulëzimit e Tiranës”, tha Rama.

## Qendrimi

### Elisa Spiropali: Nuk qeveri të pabesive

Takimin me të rinjtë në Shkodër, ishin të pranishëm Elisa Spiropali, deputeti i Malësisë së Madhe Paulin Sterkaj dhe ministri Ditmir Bushati. Spiropali ka theksuar edhe një herë qëndrimin e Partisë Socialiste kundër zgjedhjeve teknike. “Nuk duam qeveri teknike, nuk duam një qeveri të besimit të pabesive, duam një qeveri me Edi Ramën kryeministër sepse kjo ka dalë nga vota jonë”, tha ajo. Ndërsa deputeti socialist Paulin Sterkaj ftoi të rinjtë që votojnë për herë të parë të zgjedhin Partinë Socialiste si opsjon. Edhe pse në një bastion të PD, Sterkaj, tha se ndjen keqardhje që shkodranët nuk e kuptojnë synimin e kryeministrit Edi Rama. “Më vjen keq për shkodranët që nuk e kuptojnë kryeministrin që ai i do fort”, tha Sterkaj.



## FRIKA

“Kush ngujohet ka një motiv shumë të fortë për të refuzuar të ballafaqohet me njerëzit. Ngujimi në atë çadër është ngujimi që vjen prej një frike shumë të madhe. Frika nga drejtësia”.

bukën bukuria, nuk e kuptoj. Kur u pastron plehrat, sikur u ha bukën, pastërtia është shou, transformimi urban është fasadë, vetëm këta janë buka, uji e pica e demokratëve. Flisni me prindërit, flisni, dhe në fund të fundit, nëse ata hyjnë në zgjedhje, edhe na votuan dhe nuk na votuan, këta që janë demokratë të ndershëm do dinë të zgjedhin”, tha Rama.







# Dita e 50 e protestës, Lulzim Basha harron qeverinë teknike

## Kreu i opozitës nuk përmend kushtin për zgjedhjet e qershorit, akuza ndërkombëtarëve

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Për herë të parë, në ditën e 50 të protestës me turne para Kryeministrit, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, nuk e ka përmendur krijimin e një qeverie teknike si kusht për të marrë pjesë në zgjedhjet e 18 Qershorit. Kreu i opozitës, gjatë fjalës së tij në çadrën e protestës, u ndal tek Republika e Re,

domosdoshmëria e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, droga, korrupsionin, koncesionet, komploti ndërkombëtar etj., por nuk latoi asnjëherë kushtin për krijimin e një qeverie teknike. Ndërkaq, disa orë para fjalimit të Bashës, i deleguari i opozitës për negociatat me stafin e kryeministrit, Oerd Bylykbashi, ka shkruar se, në 19 maj, me shpërndarjen e Parlamentit, qeveria Rama kthehet në qeveri teknike. “Më 19 maj, maksimumi, ky parlament shpërndahet.

Kështu thotë ligji. Sado të ngefuset se dikur paska patur 1 milion vota, me pak fjalë, shumë shpejt qeveria e Edi Ramës teknikisht kthehet në qeveri “teknike”, por jo e besueshme”, shkruan deputeti i PD.

### BASHA AKUZA SHBA-BE

Kryetari i opozitës Lulzim Basha kanë përshkallëzuar sulmet ndaj faktorit ndërkombëtar (SHBA-BE), për shkak të pozicionimit kundër bojkotit të Kuvendit dhe kushtëzimit të pjesëmarrjes në zgjedhjet e Qershorit. “Në funksion të saj dhe vetëm në funksion të pushtetit dhe parave, paguhen me paratë e drogës shqiptare lobistë evropianë dhe amerikanë, fundërrina morale, të cilët bëjnë duanë e krimin të organizuar shqiptar dhe qeverisë më të korruptuar të Evropës”. “Fabula e fundit është se, ne duam të pengojmë PS të marrë pjesë në zgjedhje dhe ti fitojë ato. Fabula e fundit është se, Edi Rama po e bën gjithë këtë qëndresë jo për të ruajtur karrigen dhe privilegjet e pushtetit, që ti përdorë për ti prishur e kapur zgjedhjet e shqiptarëve, po sepse ai do të bëjë drejtësinë, ai do të bëjë shtetin. Ka ngritur bashkë me një tufë të korruptuarish ndërkombëtarë mitin se, Edi Rama donte drejtësinë dhe ne nuk e duam dhe për një kohë të gjatë. Se ne, këtu, hapim shpirtin apo jo”, tha Basha.

### REFORMA NË DREJTËSI

Lulzim Basha deklaroi dje se nuk ka ndërmend të votojë për zbatimin e reformës në drejtësi me këtë qeveri. “Kurrë, kurrë Edi Rama nuk do ta ketë në dorë drejtësinë shqiptare, se PD nuk do të jetë kurrë alibia që Edi Rama dhe kriminelët të shtinë në dorë drejtësinë shqiptare. Reformë në drejtësi alla-Shullaz, nuk ka për të pasur kurrë. Ne dhe qeveria e dalë me votë të lirë e ndershme do ta zbatojmë reformën në drejtësi jo sipas përcaktimeve Rama-Tahiri-Shullazi, para të cilave mbyllën sytë ata që nuk kanë interes reformën



Detajet

### PËR SHBA-BE

“Paguhen me paratë e drogës shqiptare lobistë evropianë dhe amerikanë, fundërrina morale, të cilët bëjnë duanë e krimin të organizuar shqiptar dhe qeverisë më të korruptuar të Evropës”.



### DREJTËSIA

“Kurrë, kurrë Edi Rama nuk do ta ketë në dorë drejtësinë shqiptare, se PD nuk do të jetë kurrë alibia që Edi Rama dhe kriminelët të shtinë në dorë drejtësinë shqiptare. Reformë në drejtësi alla-Shullaz, nuk ka për të pasur kurrë”.

## Misioni i donkishotëve Kokëdhima dhe Basha

Nëse ka një njeri, emri i të cilit është përmendur më shumë se kushdo tjetër në parlament nga ana e Sali Berishës dhe deputetët e PD-së, ai është Koço Kokëdhima. Kuptohet, nuk e përmendnin për mirë.

Çfarë nuk kanë thënë për të, dhe në fund arritën edhe ta largonin nga Kuvendi, me anë të një padie të dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila më pas i hoqi mandatin e deputetit. I tërbuar me Edi Ramën dhe Partinë Socialiste, e cila respektoi vendimin e Kushtetueses, Koço Kokëdhima ka nisur një betejë kundër kësaj partie. Një betejë donkishoteske, duke qenë se nuk ka asnjë ndjekës dhe të vetmit që e marrin seriozisht, duket se janë Ilir Meta dhe Lulzim Basha, të cilët duan të përdorin zemërimin e Kokëdhimës, për të sulmuar Ramën.

Sot Kokëdhima ka zhvilluar një takim pikërisht me Lulzim Bashën, partia e të cilit ka thënë gjithë të zezat për të dhe i hoqën mandatin.

Kokëdhima është akuzuar gjatë si nga Basha ashtu edhe nga ish-kryeministri Sali Berisha për vjedhje dhe përvetësim të pronave, veçanërisht në jug të vendit. Për Berishën dhe Bashën, Kokëdhima deri pak ditë më parë ishte kryemafiozi dhe oligarku i Jugut. Akuzat u shtuan më tepër pas kërkesës së Kokëdhimës për legalizimin e kanabisit, me opozitën që e cilësoi këtë lëvizje, si përpjekje e një trafikanti për të çuar vendin drejt humnërës narkotike. Por akuza ka patur edhe nga ana e ish-deputetit për Bashën dhe Berishën, duke i quajtur ato jo vetëm shpifës ndaj figurës së tij, por edhe hajdutë dhe vrasës (duke nënkuptuar tragjeditë e Gërdecit dhe 21 Janarit).

Por “djalli” Kokëdhima tani është kthyer në “engjell” për PD-në, dhe bashkë thonë se do rrëzojnë Ramën dhe do



Koço Kokëdhima, Lulzim Basha dhe Edi Lesi

t’i sigurojnë shqiptarëve zgjedhje të lira. Koço, që ndjekës ka vetëm këshilltarin e tij që i mban pallton, pas takimit tha se me Bashën ka diskutuar për situatën e rëndë politike.

“Biseduam rreth situatës politike në vend, diskutuam për krizën dhe për nevojën që kjo krizë të kapërcehet, për efektet negative të kësaj krizë nëse ajo vazhdon, sepse pa dyshim që kjo krizë ka ndikim në ekonomi.

Diskutuam për nevojën e standardeve të zgjedhjeve të lira, për reformën zgjedhore që duhet t’i japë një zgjidhje përfundimtare në Shqipëri.

Reforma zgjedhore është e pashmangshme dhe duhet të bëjë të mundur që në Shqipëri nuk duhet të prodhohen më zgjedhje me standarde dyshimta, por zgjedhje të lira dhe të ndershme si të gjithë vendet e tjera.

Kemi diskutuar edhe rreth nevojës së demokratizimit të partive politike, nevojës së instalimit të primareve me ligj që përfaqësuesit të zgjidhen nga populli dhe jo siç ndodh sot nga kryetarët e partive dhe nevojën që partitë

politike të kapërcehen situatën e bashkësive parapolitike në të cilën ndodhen sot dhe të kthehen në parti me standarde larta siç është e mira e vendit dhe e demokracisë”, tha Kokëdhima.

Kokëdhima tha se në këto momente janë me interes çështjet që preokupojnë qytetarët dhe jo çështjet e kaluara, duke iu referuar këto konfliktit që ai pati me PD, e cila e paditi atë dhe kjo gjë bëri që t’i hiqej mandati.

“Unë përshëndes bashkëpunimin parimor të forcave politike në Shqipëri dhe inkurajoj këtë bashkëpunim parimor dhe diskutimin parimor mes forcave politike. Unë nuk mbështes kulturën e flirteve që ka ekzistuar në Shqipëri, kulturë pazaresh mes partive të mëdha politike si në 2008, dhe po në këtë pikëpamje unë i kam denoncuar edhe veprimet kur ka qenë rasti për goditjet politike ndaj mandatit tim. Unë nuk kam ngarkesa politike me askënd, ajo është një çështje e kapërcyer. Ne kemi interes të diskutojmë çështjet e zhvillimit që preokupojnë qytetarët”, tha Kokëdhima.

Marrë nga “Tema”

në drejtësi por karrigen e Edi Ramës, për arsytet që i dinë vetë dhe turp të kenë, por ne, do të zbatojmë reformën në drejtësi që votuam sipas formulës së rakorduar, SHBA-BE. Vetëm dhe vetëm pasi 6 ligjet të kenë vullën e konsensusit opozitar sipas marrëveshjes politike të 21 Korrikut. Kush nuk ka kohë për ti dëgjuar këto detaje bën mirë të hapë veshët se nuk janë detaje. Kush i dëgjon dhe i kupton ta dijë se shteg tjetër për reformën në drejtësi nuk ka dhe nuk mund të ketë”, pohoi kreu i PD.



# 33 parti në zgjedhje, regjistrohen edhe grekët

Partia MEGA: Do përfaqësojmë minoritetin në zgjedhjet e 18 Qershorit. Edhe Bojaxhiu dhe Ngjela paraqesin dokumentacionin në KQZ

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Shtohet presioni mbi partitë opozitare për të marrë pjesë në zgjedhjet e 18 Qershorit, pa kushtin e krijimit të një qeverie teknike. 33 parti politike kanë shprehur deri më tani vullnetin për t'u bërë pjesë e zgjedhjeve parlamentare, duke dobësuar tezën, sipas të cilës, zgjedhjet nuk mund të mbahen pa pjesëmarrjen e Partinë Demokratike. Shumica e subjekteve zgjedhore, me peshë reale apo edhe modeste në elektorat, kanë dorëzuar dokumentacionin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për t'u regjistruar në zgjedhjet e qershorit. 29 parti janë regjistruar tashmë në zgjedhje, ndërsa edhe tre subjekte do të regjistrohen ditën e hënë. Në KQZ kanë paraqitur dokumentacionin për t'u regjistruar në zgjedhje edhe Partia Ligj dhe Drejtësi, e drejtuar nga Spartak Ngjela si dhe Sfidën për Shqipërinë me kryetar Gjergji Bojaxhi. Po gjatë ditëve të fundit, në KQZ ka paraqitur dokumentacionin për t'u regjistruar në zgjedhje edhe Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë. Tre subjektet në fjalë do të regjistrohen në mbledhjen e KQZ, ditën e hënë. Ndërkaq, në zgjedhje, përpos Partisë Socialiste, janë regjistruar edhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Megjithatë, LSI nuk i mendon zgjedhjet pa Partinë Demokratike, ndërsa PDIU ka një qëndrim të paqartë për këtë çështje.

## GREKËT NË ZGJEDHJE

Partitë që përfaqësojnë interesat e minoritetit grek në Shqipëri ndajnë qëndrime të kundërta në raport me zgjedhjet e 18 Qershorit. Ndryshe nga kreu i PBDNJ, Vangjel Dule, i cili ka deklaruar se partia që ai drejton nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare pa u larguar kryeministri Edi Rama, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen është regjistruar në zgjedh-

jet e 18 Qershorit, ndonëse nuk është rreshtuar ende në një koalicion parazgjedhor. Teksa kreu i PBDNJ Vangjel Dule i është bashkuar linjës së kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i cili ka kushtëzuar pjesëmarrjen në zgjedhje me krijimin e një qeverie teknike, MEGA deklaroi se do të garojë në zgjedhjet e 18 Qershorit, për të mbrojtur interesat e të gjithë minoritetit grek në Shqipëri. Me datë 29 Mars, Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë Partinë Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e qershorit.

## KREU I MEGA

Në një prononcim për Shqiptarja.com, kreu i MEGA, Kristaq Kiço, tha se partia që ai drejton nuk mund të përfshihet në lojërat e mëdha të futjes apo të mos futjes në zgjedhje, por do të marrë pjesë në zgjedhje, me



Kristaq Kiço, Kryetari i Partisë MEGA

## 18 qershori Pa LSI zgjedhjet të pamundura, bllokohet KQZ

Lëvizja Socialiste për Integrim është regjistruar në zgjedhjet e 18 Qershorit, por kreu i saj, Ilir Meta, ka deklaruar se nuk do të bëhet pjesë e një farse zgjedhore pa pjesëmarrjen e Partisë Demokratike. Nga ana tjetër, kryeministri Edi Rama ka deklaruar se zgjedhjet do të mbahen në 18 Qershorit dhe se Partia Socialiste do të futet edhe e vetme në zgjedhje. Por, duke iu referuar Kodit Zgjedhor, Lëvizja Socialiste për Integrim, ka rol përcaktues në zhvillimin e zgjedhjeve të 18 Qershorit. LSI ka një anëtar përcaktues në të gjitha komisionet e administrimit të zgjedhjeve, duke nisur që nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Anëtari i LSI në KQZ është përcaktues për shumicën e domosdoshme prej katër votash. Pa votën e anëtarit të LSI, KQZ nuk mund të miratojë asnjë vendim apo udhëzim për administrimin e zgjedhjeve. KQZ nuk mund të zëvendësojë as anëtarët e qendrave të votimit apo të grupeve të numërimit, pasi për çdo vendimarrje, duhet një shumicë e thjeshtë prej katër votash. Në këto kushte, për zhvillimin e zgjedhjeve, më shumë se sa një marrëveshje mes PD dhe PS, pikësepari duhet një pakt mes Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim.



## PARTITË QË DO MARRIN PJESË NË ZGJEDHJET E 18 QERSHORIT

1.	Partia Socialiste të Shqipërisë	18.	Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
2.	Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	19.	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë
3.	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	20.	Partia e Gjelbër
4.	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	21.	Partia Fronti i Majtë
5.	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë	22.	Partia Kristian Demokrate
8.	Partia Komuniste e Shqipërisë	23.	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë
9.	Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet	24.	Partia Emigracioni Shqiptar
10.	Partia Arbnore Kombëtare	25.	Partia e Mirëqenies Popullore Shqiptare
11.	Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë	26.	Partia Socialdemokrate të Shqipërisë
12.	Sfida për Shqipërinë	27.	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar
13.	Partia Ligj dhe Drejtësi	28.	Partia e Punës së Shqipërisë
14.	Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	29.	Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi
15.	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar	30.	Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori
16.	Partia Unitetit Kombëtar	31.	Partia Aleanca Popullore
17.	Partia Socialiste të Moderuar	32.	Partia Socialpuntere Shqiptare
		33.	Partia Forca Rinia

platformën dhe alternativën e saj, në mbrojtje të interesave të minoritetit. "Ne nuk mund të përfshihemi në lojërat e futjes apo të mos futjes në zgjedhje. Ne jemi parti që mbrojmë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtat e minoritetit dhe normalisht do të jemi pjesë e zgjedhjeve. Sepse demokracia këtë kërkon. Pastaj, gjërat e tjera si ndryshimet në Kodin Zgjedhor etj., duhet t'i zgjidhin partitë e mëdha. Ne përfaqësojmë të

gjithë minoritetin grek. Ne kemi fituar edhe një bashki në zgjedhjet lokale", tha Kiço. Kreu i MEGA tha se Dule nuk i është përgjigjur ftesës së tij për bashkëpunim. "Para dy muajsh, ne kemi bërë një propozim, për të dalë bashkë të dy partitë në koalicion më vete, por nuk kemi marrë përgjigje akoma. Gjithsesi, jemi të hapur që të ulemi të bisedojmë dhe të diskutojmë, nëse gjendet një zgjidhje e përbashkët", pohoi ai.



Detajet

## ZGJEDHJET

33 parti politike kanë shprehur deri më tani vullnetin për t'u bërë pjesë e zgjedhjeve parlamentare, duke dobësuar tezën, sipas të cilës, zgjedhjet nuk mund të mbahen pa pjesëmarrjen e Partinë Demokratike.



## MEGA

Ndryshe nga kreu i PBDNJ, Vangjel Dule, i cili ka deklaruar se partia që ai drejton nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare pa u larguar kryeministri Edi Rama, MEGA është regjistruar në zgjedhjet e 18 Qershorit, ndonëse nuk është rreshtuar ende në një koalicion parazgjedhor.





## AFATI PËR REGJISTRIMIN

Partia Demokratike dhe Partia Socialiste do të kenë edhe 19 ditë kohë për të gjetur rrugën e dialogut, me qëllim zgjidhjen e ngërçit politik, për rikthimin e opozitës në Kuvend dhe pjesëmarrjen e saj në zgjedhjet parlamentare.

## DENAR BIBA

"Vota ime do të jetë pro regjistrimit të cilësdo partie edhe përtej afatit. Natyrisht, jo përtej çfarëdolloj afati. Ky i datës 10 është thjeshtë sugjerues nga sugjerues nga Kodi"

## NENI 64 I KODIT ZGJEDHOR

## Regjistrimi i partive politike në zgjedhje

1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

## NENI 67


## Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive

1. Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëmbrore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.



## ANALIZA

## Kriza është ligjërimore



NGA ILIR YZEIRI

vijon nga faqja 1

Tani kriza po përjetohet prej të gjithëve si një spektakël, si një shfaqje. Deri edhe Xhafoja nga Cakrani përdori një shenjë të karakterit letrar kur tha që Lulëzim Basha të ndërpresë recitimin. Në mënyrë të paqëllimshme, politikanët e çadrës janë shndërruar gradualisht në showmen-ë, në aktorë. Në fakt, me rolin që luajnë në jetën publike, në një farë mënyre, politikanët janë afër rolit të aktorit, sepse përdorin fjalën, gjestet, zërin, veshjen, mimikën. Sa herë që përdoret ky përcaktim, në shkencat e komunikimit shtrohet pyetja: nëse politikanët luajnë rolin e aktorit, përse aktorët nuk bëhen politikanë? Natyrisht këto janë hamendësime teorike, por gjithsesi të çojnë drejt një thelbi të vërtetë. Shumica e studiuesve mendojnë se politikanët luajnë ashtu siç bëjnë aktorët, pra kanë një rol, përdorin zërin, gjestet, mimikën, veshjet dhe kanë po ashtu edhe një skenë apo një platë dhe, më në fund, kanë atë që çdo aktor e ëndërron – publikun. Mirëpo, ne të gjithë e dimë që ata nuk janë aktorë, por politikanë (me përjashtim të rasteve kur aktorët bëhen edhe deputetë). Ndërsa një aktor që i qëllon të luajë rolin e një politikani në teatër ne asnjëherë nuk e ngatërrojmë me një politikan. Ku qëndron dallimi? Dallimi qëndron te teksti që recitojnë dhe te roli që luajnë. Një aktor në teatër reciton një tekst të shkruar më parë, të njohur nga publiku ose edhe jo. Reciton një tekst që ka një autor të caktuar. Ky tekst apo drama që ai reciton në teatër, njihet nga të gjithë dhe është një vepër artistike, që do të thotë se është reale, në kuptimin që ngjarja që tregohet në atë dramë nuk ka ndodhur në jetë, por është krijim i fantazisë së autorit edhe në rastet kur ajo është nxitur nga ndonjë ngjarje reale që ka ndodhur në jetë. Ndërsa teksti i politikanit apo i liderit politik ka për autor vetë liderin, pra ai është edhe autor edhe aktor i tekstit që reciton. Ndryshe nga drama, teksti politik është një tekst që ndërtohet mbi një ngjarje apo mbi një perceptim real. Politikani flet për sende e ngjarje reale, në kuptimin që ato ngjarje kanë ndodhur, janë parë, për ato ka të dhëna, dhe referenca. Ndryshimi i fundit ka të bëjë me efektin që prodhon teksti dhe është ajo që Aristoteli e quante «katarsis». Në teatër spektatori, duke parë aktorët në skenë e duke ndjekur dramën, ndien një lloj shtrëngimi

shpirtëror që e detyron të bëhet njësh me emocionet e heroit të dramës, të vuajë si ai, të kënaqet si ai, të trishtohet si ai dhe në fund të dalë nga shfaqja më i filtruar shpirtërisht, më i pastruar ose më i ngarkuar. Ndërsa kur dëgjon një politikan, publiku mëson të vërtetë që ai nuk i dinte më parë dhe frymëzohet që në zgjedhjet politike të jetë më i vëmendshëm dhe të ndjekë instiktin e së vërtetës që i vjen edhe përmes tekstit politik. Po çfarë po ndodh në çadër? Ka mbi 40 ditë që Lulëzim Basha përsërit të njëjtin tekst. Në fillim, kur ai u shpalli mbështetësve të tij se kemi përballë një qeveri të kimit, një vend të mbuluar me drogë, se zgjedhjet me këtë qeveri të kimit nuk mund të bëhen, efekti i parë që duhet të prodhonte, do të duhej të ishte zemërimi popullor. Në Rumani fjala vjen qeveria hartoi një projektligj që e rriste masën e shpërdorimit që u lejohej zyrtarëve deri në përafërsisht 40 mijë dollarë dhe publiku nuk priti të ndërtohej në Bulevardin e Bukureshtit asnjë çadër, por mbushi sheshet dhe e detyroi qeverinë të tërhiqej. Në Paraguajin e largët, parlamenti miratoi një ligj që i jepte të drejtën e rizgjedhjes presidentit në detyrë për një mandat të tretë dhe mundësonte të rizgjidhej edhe presidenti i opozitës që kishte kaluar dy mandate. Populli doli në rrugë dhe dogji selinë e Parlamentit, policia vrau katër protestues. Ndërsa këtu te ne teksti që reciton Lulëzim Basha nuk prodhon asnjë efekt në publik, sepse është një tekst propogandistik i ndërtuar me një gjuhë të drunjtë që i ngjet teksteve të diktatorëve komunistë që shanin kapitalizmin natë e ditë duke e treguar atë vend si të mbytyr nga droga, nga prostitucioni dhe degjenerimi borgjez. Këto pamflete politike i kanë lodhur shqiptarët dhe sot nuk bindet askush. Ndaj edhe Lulëzim Basha dalngadalë po i ikën rolit të tij si politikan dhe po bëhet një aktor i keq që reciton tashmë një tekst që, për fat të keq, shqiptarëve u kujton fjalimet plot sharje e fyerje të Enver Hoxhës kundër kapitalizmit. Pikërisht ky kalim i tekstit politik nga një tekst real në një monolog virtual e bën qesharak folësin dhe situatën e bën komike dhe e kthen politikanin nga politikan në aktor. Tani të gjithë e përfytyrojnë çadrën si një aneks të emisionit të mirënjohur "Portokalli", me ndryshimin e vetëm se aty të bën për të qeshur vetëm një aktor. Ndaj edhe Xhafoja nga Cakrani, në mënyrë të pëvetëdijshme, shfaqti emocionin e spektatorit sipas Aritotelit. Ai ishte jo nën efektin e arsytimit tragjik që dëshiron të prodhojë Lulëzim Basha me tekstin e tij të luftës kundër kapitalizmit të kalbëzver, jo, ai ishte nën efektin e «katarsisit» aristotelicien dhe po provonte në trup emocionet dhe drithmat e turpit dhe të përqeshjes. Meqenëse e ndiente veten si pjesë të atij teksti që reciton Basha, ai në mënyrë të pavetëdijshme tregoi efektin që po prodhon aktori Basha te spektatorët që e ndjekin. Natyrisht Xhafoja ishte më i sinqerti ndër ata spektatorë, ndaj tha se u bëmë gazi i botës. Të tjerët e ndiejnë këtë efekt, por nuk kanë guximin dhe sinqeritetin e Xhafos nga Cakrani.

# Shtyhet agati, PD-PS edhe 19 ditë kohë për dialog

## Denar Biba: Vota ime pro regjistrimit edhe pas datës 10 prill. Rama flet të hënën në Report TV

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Partia Demokratike dhe Partia Socialiste do të kenë edhe 19 ditë kohë për të gjetur rrugën e dialogut, me qëllim zgjidhjen e ngërçit politik, për rikthimin e opozitës në Kuvend dhe pjesëmarrjen e saj në zgjedhjet parlamentare. Ditën e hënë skadon afati për regjistrimin e partive politike në zgjedhjet parlamentare të 18 Qershorit, por, pavarësisht parashikimeve në Kodin Zgjedhor, Partisë Demokratike do t'i lihet një hapësirë kohore deri në 29 prill për t'u regjistruar, kohë e cila mund të shfrytëzohet nga palët për të gjetur gjuhën e përbashkët. Pika 1 e nenit 64 të Kodit Zgjedhor parashikon që, çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Referuar dekretimit të datës së zgjedhjeve (18 Qershor), ky afat përfundon në datën 10 prill. Por, kur na ndajnë edhe disa orë nga përfundimi i këtij afati, 24 parti opozitare kanë refuzuar të regjistrohen në zgjedhje, si formë presioni ndaj shumicës në pushtet, për të pranuar krijimin e një qeverie teknike. Megjithatë, Shqiptarja.com ka mësuar se Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve ka vullnetin e mirë për t'i regjistruar partitë opozitare në zgjedhje edhe përtej datës 10 prill. Kjo frymë pozitive dominon tek të gjithë anëtarët e KQZ.

## KRYETARI I KQZ

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Denar Biba u shpreh për Shqiptarja.com se, në një situatë të tillë, vota e tij do të jetë pro regjistrimit të subjekteve zgjedhore, edhe përtej këtij afati. Por, Biba shtoi se edhe ky afat ka një limit, që është data 29 prill, kur KQZ duhet të printojë fletët e votimit. Ku afat përkon me depozitimin e listave të kandidatëve. "Vota ime do të jetë pro regjistrimit të cilësdo partie edhe përtej afatit. Natyrisht, jo përtej çfarëdolloj afati. Ky i datës 10 është thjeshtë sugjerues nga sugjerues nga Kodi. Në praktikën e së drejtës, afatet, si në të drejtën civile, penale apo administrative, janë afate penalizuese apo sugjeruese. Sugjerojnë që kjo gjë është mirë të bëhet brenda këtij afati, por që nuk parashikojnë ndonjë penalit nëse kjo gjë nuk ndodh. Unë po flas vetëm për votën time. Nuk e di se si do të votojnë kolegët. Por, kjo gjë nuk mund të shkojë pa fund, pasi në momentin, që është data 29 prill, që do të depozitohen listat e kandidatëve dhe që ne duhet të

nisim urgjentisht në atë moment printimin e fletëve të votimit, nëse fletët e votimit do të jenë printuar, natyrisht nuk ka më kuptim se çfarë të regjistroh", tha kreu i KQZ, Denar Biba.

## EDI RAMA FLET TË HËNËN NË REPORT TV

Ditën e hënë, që përkon me skadimin e afatit për regjistrimin e partive politike në zgjedhjet e qershorit, kryeministri Edi Rama do të flasë në Report TV, në emisionin '5 pyetje nga Babaramo', se çfarë do të ndodhë pas skadimit të afatit të parashikuar në Kodin Zgjedhor. Përpos të tjerave, kryeministri do të flasë rreth qëndrimit të mazhorancës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sa i takon mundësive për regjistrimin e partive opozitare në zgjedhjet përtej afatit të 10 prillit. Po ashtu, shefi i qeverisë pritet të fokusohet edhe tek përpjekjet për t'u ulur në bisedimeve me kryetarin e opozitës, Lulëzim Basha. Nga ana tjetër, opozita është përbetuar se nuk do të regjistrohet në zgjedhjet e qershorit pa krijimin e një qeverie teknike, e cila do të garantojë, sipas saj, zgjedhje të lira dhe të ndershme. Disa ditë më parë, partitë opozitare, paralajmëruan KQZ se nuk mund të ketë zgjedhje pa plotësuar kërkesat e tyre.



ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Parlamenti Shqiptar, në datën 11 prill, do të zhvillojë një seancë të jashtëzakonshme, për ngritjen e komisionit ad hoc për verifikimin dhe votimin e kandidatëve, të cilët janë kualifikuar në dy fazat e para, për të shërbyer në organet e Vetingut. Kryetari i Kuvendit Ilir Meta u ka dërguar dje një letër krerëve të grupeve parlamentare për t'u mbledhur në një seancë parlamentare, për ngritjen e komisionit, siç edhe parashikohet në ligjin e Vetingut. Meta njofton se seanca parlamentare do të mbahet ditën e martë, ora 18:00, ndërkohë që PD vijon bojkotin e punimeve të Kuvendit nën kushtin për krijimin e qeverisë teknike. Letra i është dërguar kreut të grupit parlamentar të PS, z Gramoz Ruci, atij të PD, Edi Paloka, Luan Ramës së LSI, Mesila Dodës së PDIU dhe Fatmir Mediu të PR. Meta u kërkon krerëve të grupeve parlamentare që të propozojnë anëtarët e komisionit. "Në zbatim të nenit 8, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016, për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, njoftoj mbledhjen e seancës plenare, ditën e martë, datë 11 prill, ora 18.00, me këtë rend dite: Miratimin e projektvendimit për procedurat parlamentare për funksionimin e komisionit ad hoc për realizimin e procesit të votimit sipas ligjit nr. 84/2016, për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Miratimi i projektvendimit të Kuvendit për krijimin dhe përbërjen e komisionit ad hoc për verifikimin e kandidatëve për institucionet e vlerësimit. Sa më sipër, ju lutem, brenda datës 11 prill 2017, ora 16.00, dërgoni propozimet tuaja për përbërjen e komisionit ad hoc për verifikimin e kandidatëve. Ky komision përbëhet nga 6 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare", thuhet në shkresën e Metës.

## PROCEDURAT

Hapja e procedurave

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE "AEF BAILIFF SERVICE" SH.P.K**  
do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme:



**1. Apartament** me Nr. Pasurie 305/146+1-40 Volum 25, Faqe 1, Zonë kadastrale 2291, 81.8 m2, me vendodhje Rr. "Prizreni", Fshati Golem, Bashkia Kavajë, në pronësi të Shpresa Xhemal Vrana e dtl. 28.03.1968.

**Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 29,440 (njëzetë e nëntë mijë e katërqind e dyzetë) Euro.**

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë "AEF BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 11.04.2017 në orën 16:00, në adresën: Kryqëzimi i 21 Dhjetorit, Rr. Muhamet Gjollështa, Pallati "Gora", kati 1, Kulla Tirane Cel : 069 20 49 300 ; Web: www.aef-al.com ; E-mail info@aef-al.com.



## SEANCA PËR VETINGUN

Parlamenti Shqiptar, në datën 11 prill, do të zhvillojë një seancë të jashtëzakonshme, për ngritjen e komisionit ad hoc për verifikimin dhe përzgjedhjen e mëtejshme të kandidatëve, të cilët janë kualifikuar në dy fazat e para, për të shërbyer në organet e Vetingut.

## PD BOJKOT

Procesi i ngritjes së institucioneve të Vetingut bllokohet zyrtarisht. Partia Demokratike ka deklaruar se nuk do të bëhet pjesë e këtij procesi, pa u zhvilluar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

DOSJA ME DOKUMENTET E AVOKATIT  
TE POPULLIT NE KUVEND

1	Listën me kandidatët që kanë përmbushur kriteret formale për secilin pozicion (84 kandidatë)
2	Listën me kandidatët që nuk kanë përmbushur kriteret formale për secilin pozicion (109 kandidatë)
3	Letrën e zj. Genoveva Riuz Calavera, drejtuar Avokatit të Popullit për përcjelljen e vlerësimit dhe rekomandimeve të vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
4	Rekomandimet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit;
5	"Protokollin për vlerësimin e kandidatëve për institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (2)", midis komisionit Ad-Hoc për mbështetjen e Avokatit të Popullit, në lidhje me reformën në drejtësi dhe nga ana tjetër prej ekspertëve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
6	Stafet e Kuvendit dhe të Avokatit të Popullit do të fillojnë procesin e inventarizimit të dosjeve për secilin kandidat.

# Seancë e jashtëzakonshme për Vetingun, PD nuk merr pjesë

Meta u kërkon krerëve të grupeve parlamentare që të propozojnë anëtarët të komisionit që do të verifikojë kandidatët për Vetingun

## KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET SIPAS AVOKATIT TË POPULLIT

1.	Arben	Lena	22.	Eljona	Lloja	43.	Juelda	Lamçe	64.	Petrit	Agaj
2.	Albana	Shtylla	23.	Elvis	Zaimi	44.	Julinda	Mansaku	65.	Rezarta	Tahiraj
3.	Albana	Tushe	24.	Enkeleida	Goxhaj	45.	Kestrin	Katro	66.	Rezarta	Abdiu
4.	Aldona	Sylaj	25.	Erin	Çaku	46.	Klara	Mullaj	67.	Roland	Gjoni
5.	Alion	Cenolli	26.	Erjona	Canaj	47.	Lindita	Xhillari	68.	Roland	Illia
6.	Alma	Faskaj	27.	Ermira	Deçka	48.	Lindita	Blinishti	69.	Rovena	Pregja
7.	Ardian	Hajdari	28.	Etlea	Çiftja	49.	Liri	Llukani	70.	Rozeta	Ivanova
8.	Ardita	Alsula	29.	Etleva	Papekaj	50.	Luan	Daci	71.	Sergjio	Mazreku
9.	Artan	Gjylbegaj	30.	Eva	Dyrmishi	51.	Lulzim	Hamitaj	72.	Shefqet	Dida
10.	Arte	Gjonaj	31.	Fatmira	Luli	52.	Mimoza	Tasi	73.	Shpresa	Beçaj
11.	Betula	Toto	32.	Fatos	Dervishi	53.	Mirion T	heodhosi	74.	Shqipe	Halilaj
12.	Bledar	Cenameri	33.	Firdes	Shuli	54.	Monika	Meça	75.	Sokol	Çomo
13.	Brunilda	Lilo	34.	Florian	Ballhysa	55.	Natasha	Mulaj	76.	Sokol	Lamaj
14.	Brunilda	Bekteshi Vasha	35.	Fredi	Mirashi	56.	Nejla	Peka	77.	Suela	Zhegu
15.	Bujar	Madani	36.	Genci	Bilali	57.	Nertila	Sadedini	78.	Suzana	Hoxha
16.	Darjel	Sina	37.	Genta	Tafa (Bungo)	58.	Nertila	Mete	79.	Suzana	Pasha Hoti
17.	Dede	Kasneçi	38.	Gentian	Gurra	59.	Noreta	Kalcuni	80.	Valbona	Sanxhaktari
18.	Diana	Dervishi	39.	Gëzim	Cenaj	60.	Olsi	Komici	81.	Valbona	Legisi
19.	Donald	Xhellli	40.	Heral	Saraçi	61.	Orjela	Shishi	82.	Vojo	Malo
20.	Edlira	Bylo Grabovaj	41.	Ina	Rama	62.	Pal	Shkambi	83.	Xhensila	Pine
21.	Edmond	Kasmi	42.	Irena	Nino	63.	Pamela	Qirko	84.	Xhilda	Pinci

për të vijuar me procesin e nominimit të kandidatëve për Vetingun vjen pasi Op-

eracioni Ndërkombëtar i Monitorimit i përcolli këtë të premte Avokatit të Popullit listën e zezë të atyre aplikantëve që nuk duhet të përfshihen në këtë proces si dhe listën e atyre duhet të përfshihen. Avokati i Popullit ia përcolli dy listat Kuvendit të Shqipërisë, po ditën e premte. Lista me 42 emrat e papërshtatshëm ndodhet në një zarf të vulosur që vetëm Kuvendi ka të drejtë ta hapë.

PD NUK MERR  
PJESË NË PROCES

Procesi i ngritjes së institucioneve të Vetingut bllokohet zyrtarisht. Partia Demokratike ka deklaruar se nuk do të bëhet pjesë e këtij procesi, pa u zhvilluar zgjedhje të lira dhe

të ndershme. Kryetari i opozitës, Lulzim Basha, i është përgjigjur negativisht ftesës së Metës për të votuar komisionin ad hoc që do të ngrejë institucionet e Vetingut. "Asgjë nuk ka ndryshuar. Partia Demokratike nuk do të bëhet pjesë e një procesi fasadë. Asnjë gjë nuk ka ndryshuar që të ndryshojmë qëndrimin për Vetingun", u shpreh Basha në një prononcim për Report Tv. Më herët, Lulzim Basha, deklaroi se reforma në drejtësi do të zbatohet vetëm nga një qeveri, e cila do të dalë nga zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kreu i opozitës paralajmëroi shtyrjen e procesit të ngritjes së organeve të Vetingut pas zgjedhjeve të 18 Qershorit.

## VERIFIKIMI

VETËM 67 KANDIDATË  
PËR ORGANET E VETINGUT

Vetëm 67 aplikantë përmbushin kriteret ligjore për të shërbyer në organet e Vetingut, që do të kalojnë në skanerin e trefishtë rreth 800 gjyqtarë dhe prokurorë. Ekipi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit ka verifikuar brenda 7 ditëve, nga 14 që është afati i parashikuar në ligj, dosjet e 193 kandidatëve, të cilët kishin aplikuar për t'u bërë pjesë e organeve të Vetingut. Në datën 31 Mars, Avokati i Popullit i kaloi ONM dy lista, një me 84 kandidatë që plotësonin kriteret formale dhe një me 109 kandidatë të cilët nuk i plotësonin kriteret. Brenda 7 ditëve, ONM ka verifikuar dy listat. Në përfundim, ONM, nga 193 aplikantë, ka kualifikuar 67 kandidatë si të përshtatshëm për të shërbyer në organet e Vetingut. Të dyja listat, ONM ia ka kaluar të premtën Avokatit të Popullit.



# Pensionet e vjetra, ja kur do t'i marrin lekët të moshuarit

**ISSH: Nga muaji maj të moshuarit do të marrin lekët. Shtesa deri në 52 lekë në muaj**

**Q**everia ka vendosur të rrite pensionet që janë caktuar para datës 31 dhjetor 1996. Ky vendim rrit pensionin nga 500 deri në 5200 lekë, në varësi edhe të llojit të punës. Por pavarisht se vendimi i qeverisë ka hyrë në Fletoren Zyrtare, pensionistët nuk i kanë marrë ende shtesat e reja. Kjo për faktin se Instituti i Sigurimeve Shoqërore është duke llogaritur pensionin e çdo të moshuari dhe më pas lekët do të hihen në llogarinë bankare, ose do të merren me pensionin e muajit pasardhës. Ky fakt është konfirmuar edhe nga nëndrejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Ali Emini. "Gjatë muajit prill do të bëhen të gjitha veprimet për ti kaluar shtesat në llogaritë personale të pensionitëve. Efektet e këtij vendimi do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji i viti 2017-të, por efekte financiare do të zbatohen nga 1 qershor i 2016-së" - u shpreh Emini në një prononcim për gazetën.



I CAKTUAR NË 1996	PENSIONI SOT
3,684	14 100
3,690	14 200
3,691	14 200
3,692	14 210
3,693	14 260
3,694	14 280
3,695	14 295
3,696	14 315
3,697	14 335
3,698	14 350
3,699	14 380

## VENDIMI

Projektvendimi ka për qëllim përmirësimin e nivelit të mirëqenies së pensionistëve në harkun kohor 1.1.1994 -31.12.1996, si dhe rregullon

e masën e pensioneve për kategoritë e grave që kanë punuar në punët e kategorisë së parë dhe të dytë, dhe minatorëve të nëntokës që kanë dalë në pension të par-

akohshëm. Projektvendimi synon të barazojë pensionet maksimale të harkut kohor 1.10.1993 - 31.12.1996, me pensionin maksimal të caktuar në harkun kohor 1.1.1997

- 31.2.1998, dhe përaftron pensionet e tjera mesatare me ato të caktuara në këtë hark kohor. Pensionet maksimale, pas kësaj rritjeje, arrijnë në 23.640 lekë në muaj. Nga

këto ndryshime do të përfillojnë 3000 pensionistë, gra që kanë punuar në punët e kategorisë së parë dhe të dytë, si dhe minatorëve të nëntokës. Efektet financiare për

zbatimin e këtij projektvendimi do të fillojnë nga data 1.6.2016 dhe do të përballohen nga fondet e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

## TAKIMI

### Meta me banorë të kryeqytetit: Zgjedhjet janë të shqiptarëve

"Pa stabilitet s'ka siguri, nuk ka qetësi, nuk ka mundësi, as për investime, as për shërbime më të mira

**K**ryetari i LSI, Ilir Meta, mori pjesë dje në një takim me banorë të njësisë administrative nr. 7 në kryeqytet. Gjatë takimit me banorët Meta, tha se LSI është një forcë politike që qëndron pranë njerëzve në mënyrë të vazhdueshme dhe se Shqipëria kë nevojë për stabilitet, siguri e shërbime më të mira. Kryetari i LSI-së theksoi gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të zgjedhjeve në një mjedis të qetë dhe demokratik. "Ne orientojmë vendin drejt stabilitetit. Pa stabilitet nuk ka siguri, nuk ka qetësi, nuk ka mundësi, as për investime, as për shërbime më të mira. Zgjedhjet janë të shqiptarëve, dhe duhen zhvilluar në një mjedis



normal, në një mjedis të qetë, në një mjedis demokratik, larg këtyre përplasjeve tërësisht jo normale", - deklaroi Ilir Meta.

Ndërkaq, Kryetari i LSI-së bëri apel për kompromis, para se të jetë shumë vonë, teksa nënvizoi se çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë janë në fokusin e LSI-së, pasi janë shumë të rëndësishme. "Kur duhet një kompromis

të gjithë duhet të lëshojnë nga pak, përpara se të jetë vonë dhe të ndodhi një përplasje apo një krizë edhe më e madhe ku do të jetë edhe më e vështirë për t'i qetësuar gjërat. Çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë, me edukimin e tyre, me punësimin, me formimin e tyre profesional janë çështjet më të rëndësishme të LSI-së", - deklaroi ndër të tjera Meta.

United Nations Development Programme



Empowered lives.  
Resilient nations.

## TENDER ANNOUNCEMENT

**Subject:** Request for proposal for a "Research Study on Brain Gain, Reversing Brain Drain with Albanian Scientific Diaspora"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested entities who wish to be considered for the above mentioned service.

The contractor will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP/2017-36805 "Research Study on Brain Gain, Reversing Brain Drain with Albanian Scientific Diaspora"**

**FOR MORE DETAILS PLEASE REFER TO THE LINK BELOW:**  
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

## RELEVANT DATES:

All interested entities should provide their proposal, not later than **19 April 2017, 17:00 hrs**, to the address:

**UNDP Procurement team**  
**United Nations Development Programme**  
**"Skenderbej" Street, Gurten Center, 2nd Floor,**  
**Tirana, Albania**



## Trafikimi

Pavarësisht mohimit të trafikut të drogës, kreu i këtij grupi dhe anëtarët e tij si dhe dy italianë janë vënë në pranga, pasi është provuar nga prokuroria e Leçes, që kanë trafikuar me skaf dhe sasi të tjera të drogës.



## Hipja në skaf

Nga të dhënat e deritanishme rezultojnë se shtetasi Eduart Sallaku, në datën 5 prill 2017 është afruar në këmbë pranë bregut të detit dhe ka hipur në skafin në pronësi të shtetasit Lazër Lazri.



## Transportimi

Lazër Lazri është kontaktuar nga shtetasi Vitor Brahja, me qëllim që të ndihmonte në transportimin e lëndës narkotike nga brendësia e pyllit për në bordin e skafit të tij dhe, më tej, ta transportonte në skafin e shtetasve italianë më në brendësi të detit.

# Shqiptarët shkëmbejnë droge në det me shtetas italianë

## Arrestohet 5 shqiptarë dhe 2 italianë në Gjirin e Lalëzimit

ELTON QYNO  
TIRANE

**N**jë hetim i përbashkët i Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Prokurorisë së

Leçes dhe Guardia di Finanza ka zbuluar një grup personash, të cilët dyshoheshin se trafikonin lëndë narkotike kanabis nga Shqipëria drejt Italisë, nëpërmjet mjeteve lundruese skaf, me pikënisje zonën e Gjirit të Lalëzimit, në Durrës dhe destinacion brigjet italiane. Deri në këtë fazë të hetimit, të paktën 7 persona, nga të cilët 5 shqiptarë dhe 2 italianë, janë ndaluar mesnatën, ndërmjet të Premtes dhe së Shtunës, me urdhër të Prokurorisë për Krime të Rënda në kuadër të këtij hetimi të përbashkët. Të ndaluarit shqiptarë janë nga fshatarë e Durrësit. Nga hetimet e deritanishme ka dyshime të arsyeshme se shtetasi Eduart Sallaku është në krye të këtij grupi kriminal, në rolin e organizatorit të trafikimit të lëndës narkotike nga Gjiri i Lalëzimit në drejtim të Brindizit. Gjatë operacionit policia dhe prokuroria nuk kanë mundur të sekuestrojnë drogë, vetëm një motorskaf. Prej tre ditësh kërkime të shumta po kryhen në zonën pyjore të Gjirit të Lalëzimit për të gjetur sasinë e drogës që do trafikoj. Por këto kërkime kanë qënë pa rezultat. Edhe në banesat e të arrestuarve është kryer kontroll, por nuk janë gjetur sende të paligjshme. Ndërkohë gjatë marjes në pyetje të të arrestuarve, asnjëri prej tyre nuk ka pranuar se ndodheshin në Gjirin e Lalëzimit me synimin për të trafikuar drogë drejt Italisë. Pavarësisht këtyre pretendimeve, kreu i këtij grupi dhe anëtarët e tij si dhe dy italianë janë vënë



### → NDIHMESA NË TOKË

Lazër Lazri është kontaktuar nga shtetasi Vitor Brahja, me qëllim që të ndihmonte në transportimin e lëndës narkotike nga brendësia e pyllit për në bordin e skafit të tij dhe, më tej, ta transportonte në skafin e shtetasve italianë më në brendësi të detit.

në pranga, pasi është provuar nga prokuroria e Leçes, që kanë trafikuar me skaf dhe sasi të tjera të drogës.

### SHKEMBIMI I DROGËS NË THELLËSI TË DETIT

Gjatë hetimit të Prokurorisë për Krime të Rënda rezultojnë se ky shtetas, në bashkëpunim me shtetasit italianë Gianfranco Maiorano (me precedente penal në shtetit Italian, më shumë se një herë) dhe Donato Carluçi, kanë bërë përgatitjet e nevojshme për të trafikuar një sasi të konsiderueshme lëndë narkotike. Nga të dhënat e

deritanishme rezultojnë se shtetasi Eduart Sallaku, në datën 5 prill 2017 është afruar në këmbë pranë bregut të detit dhe ka hipur në skafin në pronësi të shtetasit Lazër Lazri. Të dy kanë pritur ardhjen e një tjetër skafi, të nisur nga Italia, në bordin e së cilit gjendeshin dy shtetasit italianë. Lazër Lazri është kontaktuar nga shtetasi Vitor Brahja, me qëllim që të ndihmonte në transportimin e lëndës narkotike nga brendësia e pyllit për në bordin e skafit të tij dhe, më tej, ta transportonte në skafin e shtetasve italianë më në

brendësi të detit.

### PRERONAT NË TOKË PIKASËN POLICINË

Për realizimin e qëllimit kriminal, shtetasi Vitor Brahja ka kontaktuar me dy nipërit e tij shtetasin Jurgen Brahja dhe Gjon Brahja, të cilët, përveç ndihmës në ngarkimin e lëndës narkotike, do të monitoronin dhe zonën përreth për të sinjalizuar më pas Eduart Sallakun për prezencën e forcave policore. Veprimet hetimore të Prokurorisë për Krime të Rënda, ndiqeshin në terren nga ana e forcave policore të Kufirit,

### Kater te arrestuar

#### Trafikantët arrati në mal, policia i zë në pritë

**M**arrin malin përpjetë të arratisen, por policia u ka zënë pritën në disa shtigje. Kështu u kapën në flagrancë 4 të rinj në Tiranë, të cilëve iu gjetën 12 thasë me kanabis në makinat e tyre. Në këtë video që ka publikuar Policia shihet aksioni kur specialët e antitrafikut hidhen në veprim në zonën e Shën Gjergjit në Tiranë për kapjen e Endrit Varrosi, 23 vjeç, banues në Tiranë, Klajdi Disha, 19 vjeç, banues në Tiranë, Malvin Lika, 25 vjeç, banues në Tiranë, Klajdi Agaj, 22 vjeç, banues në Tiranë. Policia sekuestroon 12 thasë me kanabis sativa Sekuestrohen rreth 45 kg bimë narkotike Cannabis Sattiva të paketuara në 12 thasë. Arrestimi i këtyre shtetasve, është kryer sepse në zonën e Shëngjergjit, në automjetin tip "Opel", me të cilin po udhëtonin, janë gjetur disa mbetje lënde të dyshuar narkotike, gjithashtu nga hetimet e kryera dhe kontrollin i territorit, në afërsi të automjetit janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës material 45.3 kg lëndë e dyshuar narkotike e llojit Cannabis Sattiva. Lënda ishte e paketuara në 12 thasë. Materialet procedurale i'u kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shakallës së Parë Tiranë, për veprën penale "Prodhimi dhe shitjes e lëndëve narkotike" në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 283/2 i Kodit Penal.

### TE ARRESTUAR

- Eduart Sallaku
- Vitor Brahja
- Jurgen Brahja
- Gjon Brahja
- Lazër Lazri
- Gianfranco Maiorano
- Donato Carluçi

arsyeshme të bazuara në prova se personat e mësipërm kanë konsumuar elementët e veprave penale të "Trafikimi i narkotikëve", mbetur në tentative "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe "Grupi i strukturuar kriminal". Në këto kushte, nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda u urdhërua ndalimi i 5 shtetasve shqiptarë dhe 2 italianë. Shtetasit shqiptarë janë ndaluar me urdhër të Prokurorisë për Krime të Rënda në datën 6 prill 2017. Ndërsa shtetasit italianë janë ndaluar në datën 7 prill 2017, të cilët u gjenden në brendësi të pyllit pranë Gjirit të Lalëzimit. Në këtë operacion u sekuestrua edhe skafi me të cilin do të kryhej trafikimi i lëndës narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë. Ndërkohë nuk është arritur të gjendet asnjë sasi lëndë narkotike. Pritet që ditën e hënë të 7 personat pritët të dalin para Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku do njihen me masën e "arrestit në burg", që ka kërkuar prokuroria.







Magazina ku u gjenden 12 ton hashash

## Operacioni



**N**jë sasi rekord, prej gati 12 ton drogë u zbulua nga policia mesditën e kësaj të shtunë në një magazinë në fshatin Pagri, rreth 18 km larg Përmetit, dhe shumë pranë kufirit të gjelbërt me Greqinë. Pak orë pas aksionit masiv të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, ka përfunduar edhe peshimi i lëndës narkotike, duke kapur shifrën rekord prej 11 ton e 850 kg, e futur në 450 thasë plastike të zinj. Kjo është sasia më e madhe e drogës së magazinuar së kapur ndonjëherë nga policia e Shtetit. Në Operacionin masiv të policisë morën pjesë Antidroga, Forca e Posaçme Operacionale, Drejtoria e Policisë Gjyrokastër, Sh.Ç.B.A dhe Policia e Përmetit. Policia ka marrë në pyetje disa banorë të zonës, ndërsa pesë të tjerë, përfshirë edhe personin që administron objektin, janë shpallur në kërkim. Magazina ishte marrë me qira dhe përdorej për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, si deng me jonxhë për bagëtitë. Nëse sasia e drogës do të hidhej në treg, vlera e saj do të arrinte 6 milionë euro.

### MAGAZINA U KONTROLLUA NGA POLICIA 2 MUAJ MË PARË

Magazina ku u gjetën rreth 12 ton drogë në Përmet, ndodhet në një zonë të thyer, pranë një gryke mali. Burime për "Shqiptarja.com" thanë se para dy muajsh magazina është kontrolluar nga policia në prani edhe të personit që administron objektin, i cili ka firmosur në procesverbal. Droga mund të jetë transportuar nga zonat përreth, por edhe nga Korça dhe Skrapari apo Tepelena, nga frika e kontrolleve të policisë. Ndërkohë, policia ka shpallur në kërkim personin që administron magazinën, së bashku me katër persona të tjerë, të cilët dyshohen si posedues të lëndës narkotike.

### AKSIONI MASIV I POLICISË NË PËRMET

Një magazinë e tejm-bushur me lëndë narkotike të llojit kanabis, është zbuluar mesditën e kësaj të shtunë nga policia në Përmet. Policia e Shtetit në bashkëpunim me Sh.Ç.B.A, po zhvillojnë prej disa orësh një operacion të madh anti drogë. Gjatë këtij operacioni është zbuluar magazina në fshatin Pagri të Përmetit. Nuk raportohet ende për të arrestuar gjatë këtij operacioni, por policia



Pamje e jashtëme e magazinës ku fshiheshi 12 ton hashash

# Rekord, zbulohen 12 ton drogë në Përmet afër kufirit me Greqinë

## Sasia e kanabisit e fshehur në magazinën shtetërore, u kontrollua 2 muaj më parë

### SHKB

**Droga e tharë në magazinë pritet masa për policët**

**S**hërbimi i kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, ka nisur një hetim në komisarriatin e Përmetit për të mësuar nëse drejtuesit e këtij komisarriati, kanë qënë në dijeni të kësaj magazine të mbushur plot me drogë. Pritet që për këtë hetim, drejtuesit e shërbimit të kontrollit të brendshëm, të informojnë ministrin Fatmir Xhafaj me një raport konkret. Në ditët në vijim pritet që pikërisht në këtë komisarriat ministri Xhafaj të marrë masa administrative ndaj drejtuesve të këtij komisarriati.

ka skeduar disa persona, të dyshuar si të lidhur me trafikun e drogës. Ndërkohë, magazina ku u gjet droga nuk ka pronar, pasi rezultoi të jetë pronë shtetërore, që shërbën për rezervat e shtetit. Operacioni vijoi për disa orë në të gjithë zonën e Përmetit. Nuk ka asnjë person të arrestuar nga operacioni i policisë në Përmet. Vendi ku u gjet sasia e konsiderueshme e lëndës narkotike, rezultoi pa pronar.

### VLERA 6 MILION EURO

Sasia e drogës e sekuestruar në një magazinë në fshatrat kufitare me Greqinë në Përmetit, kap një vlerë prej gati 6 milion euro. Kjo shumë financiare mund të realizohej vetëm nëse do të shitej e gjitha në Itali, kundrejt një çmimi prej 500 euro për 1 kg kanabis. Sasia e drogës, ishte tharë dhe setruar në këtë magazinë, me shpresën e mos kapjes nga policia. Ka dyshime të forta se lënda narkotike, pikërisht në këtë magazinë do të përpunohej dhe paketohej, nga ku mund të trafikohet më pas në Greqi.

### NE 2 JAVE JANE SEKUESTRUAR 18 TON DROGE

- Zbulohet magazina me 12 ton drogë në Përmet, 8 prill 2017
- Kapet gomonia me 1.4 ton kanabis, 8 prill 2017
- Zbulohet tuneli me 2 ton drogë në Mat, 5 prill 2017
- Vlorë, sekuestrimi i 1.7 ton drogë arrestohet pronari i stanit, 4 prill 2017
- Vlorë, sekuestrohet rreth 1.3 ton kanabis, ishte fshehur në pyll, 19 mars 2017
- Karaburun, trafikantët braktisin gomonen me 750 kg kanabis, 27 mars 2017
- Berat, zbulohet magazina me 1 ton drogë, 23 mars 2017

### TRE SHTETE

## Ndjekje në Shqipëri Itali dhe Greqi kapen 1.4 ton kanabis



**D**y ditë më parë një operacion nga tre shtete, Shqipëri, Itali dhe Greqi është finalizuar me sekuestrimin e një gomoneje me 1.4 ton kanabis nga roja bregdetare helene dhe arrestimin e tre skafistëve. Të arrestuarit janë shtetasit me iniciale D. L., 27 vjeç banues në Fier, K.S., 19 vjeç banues në Fier dhe A. A., 36 vjeç banues në Vlorë. Roja Bregdetare ka njoftuar për një mjet lundrues të dyshimtë që lëvizte me shpejtësi të madhe në jug të Shqipërisë në afërsi të Korfuzit. Menjëherë Policia e Shtetit në bashkëpunim me Guardia di Finanza në Durrës dhe Vlorë, kanë sinjalizuar dhe janë aktivizuar njësitë Guardia di Finanza në Bari e Taranto si dhe Frontex. Pas intervepsionit në det në afërsi të Kalabrisë ka filluar një ndjekje e gjatë në det të gomones oqeanike me motorë të fuqishëm nga 400 cv. Ndjekja ka filluar në mbrëmjen e datës 6 Prill dhe ka përfunduar rreth orës 16:00 të datës 7 Prill në pjesën fundore të Greqisë, falë edhe informimit në kohë reale të Rojes Bregdetare greke e cila ka aktivizuar të gjithë potencialin e saj. Në përfundim të operacionit janë arrestuar tre skafistët që ishin në bord dhe janë dhe sekuestruar rreth 1500 kg lëndë narkotike. Ndërkohë vazhdon punë për identifikimin e të arrestuarve dhe zbulimin e plotë të rrjetit të trafikut të drogës.



■ **DEGA DIZANJ**

Prokuroria tha se 17-vjeçaria ishte pjesë e shkollës "Murialdo". Që në fillim prokuroria dhe policia dyshuan për një vdekje natyrale.

■ **15 PERSONA**

Për këtë ngjarje janë marrë rreth 15 persona dhe se sapo të njihen me aktin e ekspertimit zyrtar, do të vendosin nëse do të pushojnë dosjen

# Vdekja e nxënësës në tualet, eksperti: I ka pushuar zemra

## Ana Rina është gjetur e pajetë nga shoqet e saj. Prokuroria pritet të mbyllë hetimet

ELTON QYNO  
TIRANE

**A**na Rina, nxënësja 17-vjeçare e një shkolle private në Fier që gjeti vdekjen brenda në tualetin e shkollës, rezultoi të ketë ndëruar jetë për shkak të një ataku kardiak. Ky ka qënë rezultati paraprak i ekspertëve të mjekësisë-ligjore, të cilët kanë kryer ekzaminimin e trupit të pajetë të 17-vjeçares. Ajo kishte patur më herët probleme sipas familjarëve, por kurrë nuk kishte ndodhur që të pësonte një atak kardiak. Nga

ana tjetër prokuroria e Fierit ende nuk është njohur me raportin përfundimtar të ekspertëve mjeko-ligjorë, megjithëse është njoftuar paraprakisht se shkak i vdekjes së 17-vjeçares ka qënë pushimi i zmerës. Sipas hetuesve, për këtë ngjarje janë marrë rreth 15 persona dhe se sapo të njihen me aktin e ekspertimit zyrtar, do të vendosin nëse do të pushojnë dosjen ose do kryejnë veprime hetimore shtesë.

### VAJZA JO ME SHENJA DHUNË NË TRUP

Ana Rina, një vajzë 17-vjeçare nga Fieri është gjetur e pajetë në tualetin e shkollës private ku ajo studjonte. Vdekja misterioze në

ambjentet e shkollës ka habitur opinionin publik në Fier, ndërkohë pas kësaj ngjarje, policia dhe prokuroria e këtij qyteti nisën menjëherë hetimet. Kanë qënë nxënësit e tjerë, të cilët kanë gjetur trupin e saj pa jetë në tualetin e shkollës. 17-vjeçarja është transportuar me urgjencë në spitalin e Fierit, por mjekët janë shprehur se kishte ndëruar jetë. Prokuroria e Fierit ende nuk ka ngritur një pistë konkrete lidhur me këtë ngjarje të rëndë, pasi sipas hetuesve ende nuk kanë në dorë aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, që do të përcaktonte zyrtarisht shkaqet e vdekjes së vajzës. Për momentin, prokuroria ka administruar në dosje

telefonin e 17-vjeçares, për të mësuar komunikimet e fundit të vajzës. Ndërkohë nga kqyrja e trupit të pajetë të vajzës, nuk janë konstatuar shenja dhune.

### U MBYLL VETË BRENDA NË TUALETIN E SHKOLLËS

Gjatë marrjes në pyetje shoqet e nxënësës së shkollës private "Murialdo", kanë rëfyer se Ana Rina, nuk u ishte ankuar gjatë ditës për gjëndjen jo të mirë të saj. Sipas tyre, Ana ka qënë shumë mirë dhe gjatë orës së mësimi dhe orareve të pushimit. Në pyetje janë marrë dhe disa prej mësuesve të vajzës, të cilat kanë treguar të gjithë kronologjinë e orëve të mësimi. Prokuroria tha

se 17-vjeçaria ishte pjesë e shkollës "Murialdo" për formim profesional në degën e dizajnit. Dyshimet e para të policisë janë ngritur se vdekja mund të ketë ardhur nga helmimi ose problemet shëndetësore.

### "VAJZA KISHTE QENË SËMURË"

Një prej punonjëse e shkollës "Murialdo" në qytetin e Fierit u shpreh se vajza para një jave kishte pasur probleme shëndetësore. Prej orës 15:00 të datës 6 prill trupi i vajzës 17-vjeçe që ndërroi jetë në tualetin e shkollës, është ekzaminuar nga mjekët-ligjorë. Pas përfundimit të ekspertizës, familjarët e të ndërës kanë tërhequr trupin e pajetë nga morgu i spitalit.



Shkolla "Murialdo" ku u gjend e vdekur 17-vjeçarja

## LAJME SHKURT




### Konflikti në Elbasan, arrestohen 4 persona 1 shpallet në kërkim

Janë arrestuar në flagrancë 4 shtetas për ngjarjen e ndodhur në fshatin Katund i Ri ku mbetën të plagosur 3 persona, dy me armë zjarri dhe një me sende të forta. Policia ka arresuar, Hajdar Bako (Çopja) (Hysa) 33 vjeç, banues në Elbasan, Alfred Gjini 38 vjeç banues në Elbasan, Klevis gjini 26 vjeç, banues në Elbasan dhe Emiljano Gjini 22 vjeç, banues në Rrogozhinë. Policia ka shpallur në kërkim kërkim Franc Gergely 25 vjeç banues në Elbasan. Janë duke vijuar punimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Policia ka sekuestruar si provë materiale një pistoletë model 56, një krëhër me 6 fishekë, dhe 3 automjete.

### U gjetën pajetë në brigjet shqiptare identifikohen 2 peshkatarët italianë

Identifikohen dy trupa të cilët u gjetën në brigjet e Vlorës, ata u përkasin dy peshkatarëve italianë që rezultojnë të zhdukur. Mediat italiane thonë se Sante Lanzillotti e Francesco De Biasi respektivisht 48 dhe 46 vjeç janë identifikuar nga të afërmit e tyre. Ka qënë djali i Sante Lanzillotti i cili ka njohur të atin nga tatuazhi që ai kishte në trup. Dy peshkatarët italianë ishin nisur me anije nga



porti Torre Santa Sabina që në datën 15 mars me synim për të peshkuar. Trupat e tyre gjenden në një morg në Vlorë dhe pritet që shumë shpejt të dërgohen në Itali. Mediat italiane shkruajnë se dy peshkatarët janë mbytur për shkak të kontaktit me ujën e ftohtë, por përgjigja e autopsisë do të japë verisonin më të saktë.

### Fushë-Krujë, shpërthim në gurore, i vendosin 200 gr tritol



I vendosin 200 gramë tritol, shpërthim në një gurore në fshatin Borizanë të Fushë-Krujës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:30 të kësaj të shtune ndërsa sasia e eksplozivit ishte vendosur pranë kabinës elektrike të gurores të shtetasit R.Sh. Nga shpërthimi i fatmirësisht nuk ka pasur të lënduar, por puna e biznesit është pezulluar pasi nga dëmet e pësuar nuk mund të furnizohet me energji elektrike. Policia ka mbërritur në vendngjarje dhe po heton mbi shkaqet e mundshme të vendosjes së tritolit.

### Shoqja pa patentë, i riu-policit: "Pi një kafe me këto"! Arrestohet

Persona të tjerë janë arrestuar pasi kanë tentuar të korruptojnë oficerët e Policisë Rrugore në Tiranë. Policia ka vënë në pranga 34-vjeçarin Edion.N, pasi i ka dhënë 5 mijë lekë të reja policit në momentin që shoferja ka rezultuar e dehur në timon. Gjithashtu edhe një 23-vjeçar është arrestuar pasi i ka dhënë 20 euro oficerit të policisë, për shkak se shoferja nuk kishte leje drejtimi. Ndërkohë Emiljano.M ka tentuar t'i japë 100 euro policit, pasi ka rezultuar i dehur. Edhe 38-vjeçari Jetmir.M nga Kosova është arrestuar menjëherë pasi i ka dhënë 15 euro policit dhe është kapur nga radari që ecte me shpejtësi. Policia e Tiranës ka publikuar edhe video e momentit të arrestimit të 4 personave, të cilët pavarësisht paralajmërimeve të policisë kanë futur lekët mes dokumenteve.



### Vodhi banesën e të moshuarit pranga një 29-vjeçari në Fier

Vodhi një banesë në Patos, Policia e Fierit arreston 29-vjeçarin. Eduart Çauhaj, banues në lagjen "29 Marsi" Patos, gjatë orëve të natës së datës 06 prill 2017 gjatë ka vjedhur banesën e shtetasit P.L, 63 vjeç. Policia ndalon një shtetas të shpallur në kërkim dhe arreston në flagrancë një tjetër për veprën penale të vjedhjes. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Policisë Fier, arrestuan në flagrancë shtetasin: Eduart Çauhaj, 29 vjeç, banues në lagjen "29 Marsi" Patos. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi më datën 6 prill 2017, gjatë natës, në lagjen "29 Marsi", ka vjedhur me thyerje banesën e shtetasit P.L, 63 vjeç.





# Vritet Artan Cuku pasi përcolli gruan uqëlluame 4 plumba

ELTON QYNO  
TIRANE

Vritet poshtë pallatit të tij ish-drejtuesi i Policisë së Vlorës Artan Cuku. Ish-zyrtari

i lartë i policisë së Shtetit, ka përcjellë familjen e tij, gruan dhe dy fëmijët për në banesë, ndërkohë që vetë ka qëndruar për disa minuta në një supermarket për të blerë diçka. Teksa ka dalë nga supermarketi ai është përballur me dy persona në hyrje të pallatit, të cilët e kanë qëlluar nga afër me katër plumba. Tre nga plumbat Artan Cuku i ka marrë në gjoks ndërsa një të katër ai e ka marrë në kokë, duke gjetur vdekjen e menjëhershme. Pas katër krismave që lemerisën banorët e pallatit dhe të gjithë zonës në rrugën e "Kosovarëve", dy autorët janë larguar me vrap, në drejtim të një motori, duke ikur me shpejtësi në drejtim të liqenit dhe më pas Saukut. Policia e Tiranës e njoftuar për këtë ngjarje nga një telefonatë anonime ka shkuar me shpejtësi në vendin e krimit, duke rrethuar të gjithë zonën dhe shoqëruar disa persona, për marrjen në pyetje të tyre. Artan Cuku njihet si një nga oficerët më të mirë të policisë së Shtetit. Ai ka shërbyer për gati 24 vite në polici, duke shërbyer në funksione të ndryshme, deri në drejtor i Policisë së Vlorës, nën/drejtor policie në Tiranë e në shumë rrethe të tjera. Cuku kishte marrë gradën madhore "Drejtes i Parë", por në 2014 u shkarkua nga policia me firmën e Artan Didit. Që prej kësaj dite Cuku nuk ka mundur të rikthehet në polici megjithëse kishte fituar në gjykatë të drejtën e rikthimit në punë. Gjatë kohës së qëndrimit i papunë Cuku është marrë me aktivitet privat, pasi kishte hapur kompaninë e sigurimit "INTERNATIONAL SECURITY ALBANIA"

## TRE PISTA HETIMORE

Vrasja e ish-nëndrejtorit të Policisë së Tiranës Artan Cukut, ka sjellë mobilizimin e të gjithave strukturave hetimore të kësaj policie, me qëllim identifikimin dhe arrestimin e autorëve të krimit. Hetimet janë drejtuar në tre pista ku e para bën fjalë se krimi mund të ketë ndodhur për shkak të detyrës së tij si polic dhe e dyta bën fjalë për shkak të konkurrencës, pasi Artan Cuku kohët e fundit menaxhonte një kompani private sigurimi. Ndërkohë pista e tretë sipas grupit të hetimit është ajo hakmarjes pasi ka dyshime të forta se ekzekutimi i ish-drejtuesit të Lartë të Policisë, lidhur me një ngjarje të vitit 2005, kur në zyrën e tij është vetëvrasur 25-vjeçari Artan Daka. Në atë kohë Artan Cuku ka qenë me detyrën e shefit të krimeve në komisariat nr. 4 në Tiranë, kur kishte shoqëruar shteta-

## Dy persona e qëlluan në hyrje të pallatit Tre pistat hetimore ku po heton policia

sin Artan Daka, ky i fundit vllai i një personi të kërkuar nga policia. Gjatë intervistimit të tij, Cuku ka pretenduar se Daka i ka marrë pistoletën e shërbimit dhe me të ka qëlluar veten duke gjetur vdekjen e menjëhershme. Këtë version Cuku ka treguar në polici, dhe është marrë i mirqënë. Ndërkohë që edhe familjarët e viktimës kanë dhënë besën që nuk do hakmeren. Mirëpo pas 12 vitesh, duke se kjo ngjarje mund të jetë riaktivizuar, çka mund ti ketë shtyra ata të hakmeren.



Trupi i pajetë i Artan Cukut

## BIOGRAFIA

Artan Cuku njihet si një nga oficerët më të mirë të policisë së Shtetit. Ai ka shërbyer për gati 24 vite në polici, duke shërbyer në funksione të ndryshme, deri në drejtor i Policisë së Vlorës, nën/drejtor policie në Tiranë e në shumë rrethe të tjera.



## KRYETARI I SHOQATES

# Flet shoku i Artan Cukut, Aleks Hajdari: Shteti e la vetëm përballë krimit

## Fitoi gjyqin dhe nuk e rikthyen në detyrë e tij të ligjshme

Aleks Hajdari, kryetari i Shoqatës së efektivave të Policisë në Lirim ka reaguar duke thënë se vrasja e Artan Cukut, lidhet drejtpërdrejt me detyrën e tij, si ish-funksionar i Lartë të Policisë. Në një intervistë për "Shqiptarja.com" një nga shokët e ngushtë të Cukut, Hajdari kujton momentet kur Cuku u lirua nga ish-kryepolici Didi dhe më pas u persekutua në detyra të ulëta, persekutime që zgjatën deri në shkarkimin e plotë të tij nga rradhët e policisë. Më tej hajdari kujton se Cuku edhe pse mundi të fitojë gjyqin për rikthim në detyrë, vendimi gjyqësor asnjëherë nuk u zbatua nga krerët e lartë të policisë, për futjen në punë të tij, duke e lënë mes katër rrugëve dhe të pambrojtur përballë dorës kriminale. Ligjërishi Cuku ishte në detyrë.

**Zoti Hajdari, sot dora kriminale sërisht qëllon mbi një efektiv policie, mbi një efektiv që i ka shërbyer me përpikmëri shtetit në funksionet më të larta?**

Me keqardhje dhe hidhërim të thellë dje në mbrëmje rreth orës 20:30 u ndërhkua me vdekje nga dora kriminale kolegu dhe një ndër



Aleks Hajdari

## ARTAN CUKU

Në të gjitha këto detyra ka mbajtur funksione të larta drejtuese, ku me punën, guximin, vendosmërinë, profesionalizmin e tij dhe stafit me të cilët ka punuar ka arritur rezultate të ndjeshme në luftë kundër krimit dhe trafikëve të paligjshme.

ish-drejtuesi dhe viktimë e krimit makabër e pa veten në rrugë, i braktisur nga shteti që i sherbeu, nga struktura policore për të cilën ai sakrifikoji dhe u përball çdo ditë me krimin dhe kriminelët për mbi 24 vite të karrjerës së tij policore.

**Si e njihnin ju Tanin, si ishte ai me uniformën e policisë dhe si ishte civil?**

Si qytetar i këtij vendi dhe djali i Dibrës atë i gjithë rrethi shoqëror, intelektual, në komunitet ku ka shërbyer dhe banuar e njihje si mishërim i njeriut i cili mbarte dhe reflektonte vlerat më të larta njerëzore, morale, profesionale dhe familjare.

**Cfarë do të thotë për Policinë e Shtetit kjo vrasje?**

Për ish-kolegët tanë që sot nuk janë të pakët në rrugë dhe jashtë strukturës policore do të thotë një humbje e dyfishtë pasi jo vetëm humben kolegun e tyre dhe familja humbi babain, bashkëshortin, djalin, vëllajin, por akoma më i rëndë është fakti që krimi arrin ta ekzekutojë në mënyrë barbare e mafioze në zemër të kryeqytetit dhe në pragun e shtëpisë së tij teksa po shkonte pranë fëmijëve të tij. Vrasja

mafioze e natës së djeshme ndaj ish-drejtuesit dhe kolegut tonë tregon me zë të lartë se sa të braktisur dhe të pasigurte është sot e gjith armata e ish-drejtuesve dhe ish-punonjësve të policisë që sot ndodhen në rrugë, në mëshirë të fatit, të ekspozuar përballë krimit dhe politikave të ndërmarra nga një prej drejtuesve më famëkeq që ka njohur dikasteri i MB dhe ish Drejtori i Policisë së Përgjithshme Artan Didi. Këto të dy ish-drejtues me militantizmin politik dhe me të vetmin qëllimin largimin nga rradhët e policisë të atyre që nuk bënin shërbime politike ndërmorrën largimin masiv të drejtuesve dhe punonjësve të policisë ndër to dhe i ndjeri kolegu ynë Artan Cuku, duhet të mbajnë përgjegjësi ligjore në lidhje me ngjarjen e rëndë. Megjithëse me vendim gjyqësor fitoi të drejtën e kthimit në detyrë të dy keta ish-drejtues politik nuk denjuan të zbatonin vendimin gjyqësor me gjithë kërkesat e herë pas herë të të ndjerit, për tu rikthyer në profesionin që aq shumë e dashironte.

**Ju si kryetar i Shoqatës të efektivave të policisë në Lirim, keni marrë kontakte me policinë, për të mesuar se çfarë masash janë marrë lidhur me identifikimin e autorëve të krimit?**

Me gjithë interesimin tim dhe të të gjithëve kolegëve të tij akoma nuk ka asnjë informacion apo pistë hetimi të bazuar që çon në zbardhjen e autorëve dhe rrethanave e motiveve të këtij krimi. Për ne si shoqatë dhe kolgë të tij pavarësisht njoftimëve mediatike të deritanishme jemi të bindur që kolegun tonë e vrau dora e krimit, për shkaqe që lidhen me detyrat që ai ka kryer.



# SHBA sulmojnë sërish sirinë, Rusia kërcënon me hakmarrje

## Administrata Trump e vendosur për të ndërmarrë goditje të tjera ushtarake

Shtohen tensionet në arenën ndërkombëtare, ndërsa Washingtoni ditën e premte hodhi një hap konkret teksa lëshoi 59 raketa mbi Sirinë, si shenjë hakmarrje për sulmin me armë kimike në provincën Idlib. Sulme të reja ajrore janë kryer dhe ndaj qytetit sirian Khan Sheikhoun, që ishte dhe vendi i sulmit me armë kimike të së martës. Lajmin e bën të ditur rrjeti informativ amerikan, CNN, që citon aktivistë të të drejtave të njeriut. Dy ditë më parë marina amerikane qëlloi me raketa "Tomahawk" një bazë ajrore siriane, veprim ky që acaroi Rusinë, mbështetëse e regjimit të presidentit sirian Bashar al Assad. Rusia nga ana tjetër si mbështetëse e regjimit Assad e dënoi sulmin amerikan. Një ngjarje e tillë trazoi arenën ndërkombëtare. Mediat raportojnë se Kremlin ka kërcënuar SHBA se është vetëm një hap larg nga lufta. Ndërsa administrata e Trump duket e vendosur se do të përgatitet edhe për sulme të tjera duke ndërmarrë mes të tjerash edhe sanksione ndaj regjimit Assad.

Kryeministri rus Medvedev denoncoi sulmin e SHBA duke thënë se sulmoi një shtet sovran si Siria dhe se ka thyer ligjin ndërkombëtar pa miratimin e OKB. "Aksioni ushtarak është një shenjë e qartë se presidenti i SHBA është i varur nga pikëpamjet e Washingtonit, cka vetë presidenti i ri kritikoi në fjalimin e tij të parë të inaugurimit. Shumë shpejt pas fitores, vura re se cdo gjë do të varej në mënyrën sesi premtimet e Trump do të thyeshin pasi ekziston një makinë e madhe fuqie. Dhe u dëshën vetëm 2 muaj e gjysmë që kjo të ndodhte. Në vend që të bashkëpunojmë në luftën kundër ISIS, administrata Trump provoi se do të luftojë qeverinë legjitime siriane" u shpreh kryeministri.

Presidenti rus po ashtu raportojnë mediat është përgjigjur duke dërguar në Detin Mesdhe luftanijet Grigorovich pikërisht në vendin ku dhe u hodhën raketat amerikane.

Deri më tani dukej se raportet mes Washingtonit dhe Moskës po përmirësoheshin por çështja e Sirisë ka vënë sërish përballë dy nga fuqitë më



të mëdha të botës.

Ndërsa shumë frikësohen se jemi përballë Luftës së Tretë Botërore.

### DEPARTAMENTI

Qëndrimi i Moskës ndaj sulmit amerikan në Siri, për Uashingtonin ishte zhgënjyes por jo i papritur. Nga sa pohoi sekretari i shtetit Rex Tillerson, vetëm habi që nuk ka pasur në administratën amerikane nga ky reagim. "Jam tejet i zhgënjyer nga përgjigja e Moskës, sepse kjo dëshmon mbështetjen e vazhdueshme të saj ndaj qeverisë së Bashar Al Assadit dhe në veçanti, përkrahjen për një regjim që është i aftë të ndërmarrë sulme të tilla të llaharshme mbi popullin e vet. Fatkeqësisht nuk mund të them që ishte ndonjë surprizë e madhe për ne", ka thënë Tillerson.

Mësymja me raketa Tomahawk e bazës siriane nga ku besohet se u nisën avionët me lëndë kimike, i kushtoi jetën

6 personave. Vladimir Putin foli për agresion kundër një kombi sovran e Moskës premtoi forcimin e mbrojtjes anti-ajrore të Sirisë. Irani e Kina kundërshtuan gjithashtu ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara. Megjithatë veprimi i Trumpit u përshëndet nga shumë vende të mëdha, e përpos kësaj, gjeti edhe mbështetje të gjerë dypartiake në radhët e Senatit amerikan, ndonëse pati edhe naëtarë të shqetësuar nga fakti që presidenti nuk kërkoi autorizimin e kongresit për një veprim të tillë ushtarak.

Në krah të Trumpit dolën deri edhe disa prej kundërshtarëve të tij më të fortë politikë. Kreu i pakicës demokrate, senatori Chuck Schumer tha se goditja amerikane ishte veprimi i duhur pas sulmit shokues të ushtrisë siriane me armë kimike, ndërsa liderja e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi u shpreh se kjo ishte vërtetë

## Konflikti

Deri tani dukej se raportet mes Uashingtonit dhe Moskës po përmirësoheshin por çështja e Sirisë ka vënë përballë dy nga fuqitë më të mëdha. Shumë mendojnë se jemi përballë Luftës së Tretë Botërore



## Ndërprerja

Rusia ka pezulluar menjëherë komunikimin normal me SHBA nëpërmjet një linje telefonike të specializuar ushtarake, krijuar për të parandaluar konfliktin midis dy superfuqive, pas sulmeve ajrore në Siri



"përgjigja e duhur".

### RUSIA

Rusia ka intensifikuar përgjigjen e saj ndaj sulmit ajror të SHBA-ve, mbi Siri, duke dërguar një anije luftarake në Mesdheun lindor, për t'u përballur me flotën e Marinës amerikane, nga ku u lëshuan raketat mbi Siri. Fregata "Admiral Grigorovich", e Putinit, la sot portin e Sevastopolit, në



Krime, për t'u vendosur përballë dy anijeve shkatërruese amerikane, USS Porter dhe USS Ross, nga ku nisi sulmi ajror amerikan. Fregata 4000 tonëshe është e pajisur me raketa potencialisht vdekjeprurëse dhe është drejtuar portit sirian "Tartus", raporton agjencia ruse e lajmeve TASS.

Ministria e Jashtme ruse e quajti një "qasje të papërgjegjshme", sulmin amerikan mbi Siri. "Shtetet e Bashkuara nuk mund të mos e kuptojnë faktin se trupat qeveritare siriane nuk kanë përdorur armë kimike atje. Damasku, thjesht nuk i ka këto armë kimike, siç është konfirmuar nga një numër i madh ekspertësh të kualifikuar. Është e qartë se sulmi amerikan ishte i përgatitur paraprakisht dhe se ngjarja me armë kimike shërbeu vetëm si pretekst për një shtafje të forcës", u tha nga Ministria e Jashtme Ruse.

Si rrjedhojë e tensionit në rritje, Rusia ka pezulluar komunikimin me SHBA-të, nga një linjë telefonike e specializuar ushtarake, e projektuar për të parandaluar konfliktin midis dy superfuqive, pas sulmeve ajrore në Siri. Kjo linjë telefonike, e quajtur "deconfliction line", ndërmjet Ruisë dhe SHBA-së, ka qenë e përshkruar si e papërsosur, por thelbësore në kohën e tensioneve. Në këtë linjë, një kolonel amerikan rusisht-folës, mban kontakte me homologët rusë në Siri dhe pikërisht nëpërmjet kësaj linje, SHBA njoftoi Rusinë për sulmet e pashmangshme të së premtes në mëngjes mbi Siri. Kjo linjë telefonike shqërben edhe si një

kanal i sigurimit të fluturimeve.

Ndërsa nuk pranon që Siria përdori armë kimike, Rusia tha gjithashtu se shumë prej raketave amerikane nuk goditën objektivat, një version i ndryshëm nga ai i dëshmitarëve në terren, që thonë se baza ajrore nga ku u nisën sulmet kimike të së martës, nuk ekziston më. Dmitry Peskov, zëdhënësi i presidentit rus Vladimir Putin e cilësoi sulmin amerikan një "akt agresioni kundër një shteti sovran", i njëjti term i përdorur edhe nga zyrtarë sirianë, diçka që vë në dukje se askush nuk e quan akt lufte.

Analistët thonë se, pavarësisht kërcënimit rus për të përforcuar mbrojtjen ajrore siriane, kjo zor se do të ketë efekt frenues, nëse Shtetet e Bashkuara planifikojnë sulme të tjera. Rusia ka dislokuar në Siri sisteme raketash tokë-ajër nga më të sofistikuarit dhe radarë me rreze të gjatë veprimi, por për arsye që nuk dihen nuk kanë ndaluar dot asnjë sulm izraelit. Avionët izraelitë hyjnë e dalin nga hapësira ajrore siriane me lehtësi të madhe dhe bombardojnë pa u shqetësuar dhe ku të duan armiqet e përbetuar të Hezbollahut, që luftojnë përkrah Bashar al-Assadit, por as Siria dhe as Rusia nuk kanë ngritur gishtin kundër tyre.

Sulmi ndaj bazës "Shayrat" u autorizua nga presidenti Donald Trump në formë raprezjale për sulmet me armë kimike, që regjimi i Assadit kreu ndaj popullsisë civile. Misteri i madh është se cilat janë hapat që do të pasojnë, por kjo mbetet për t'u parë.

## AUTORI/ POLICIA E SIGURTË QË KA KAPUR ATENTATORIN UZBEK

# Suedia në ditë zie për viktimat e sulmit të Stokholmit

Famujt janë ulur në gjysmështrirë në kryeqytetin suedez pas sulmit tragjik të së premtes, që mori 4 jetë njerëzish e plagosi 15 të tjerë, ndër të cilët edhe fëmijë. Ishte e njëjta metodë e preferuar tashmë nga ata që po kërkojnë të mbjellin terrorin në Europë: përplasje me kamion mbi këmbësorët e pafajshëm dhe tërësisht jodyshues ndaj asaj që mund të ndodhë. Personi i arrestuar mbremjen e një dite më parë duket se është drejtuesi i mjetit e policia nuk përjashton as mundësinë e ndal-

imeve të tjera. Sipas gazetës suedeze "Aftonbladet", i prangosuri është një 39-vjeçar nga Uzbekistani, përkrahës i ekstremistëve të Shtetit Islamik. Agresori e kishte vjedhur kamionin në një fabrikë birre e ishte turrur më pas me shpejtësi të lartë në një rrugë qendrore dyqanesh në Stokholm. Për kryetarin e bashkisë së qytetit, reagimi i policisë ka qenë i lavdërueshëm e ai i publikut të gjerë gjithashtu. "Falenderimet e mia më të sinqerta shkojnë për policinë, departamentin e zjarrfikësve, për qyte-

tarët që u kujdesën për njëri-tjetrin, që u hapën shtëpitë e tyre të panjohurve, të cilët nuk kishin mundësi të ktheheshin në banesat e veta. Ky nuk ishte një sulm për tregojmë se me një integrim të mirë, me sinqeritet dhe një sjellje miqësore jemi më të fuqishëm e më të bashkuar dhe nuk ka rëndësi se nga vjen. Në Stokholm janë të gjithë të mirëpritur", ka thënë Karin Wangarfd, kryebashkiake e Sotkholmit. Njerëzit ndërkohë janë ende të trondit-

tur. "Është e tmerrshme, sidomos për personat e prekur dhe familjet e tyre. Më rri mendja te fakti që aty mund të kishte qenë dhe familja ime, sepse ndodhi shumë pranë zonave ku njerëzit jetojnë", thotë Cecilia Hansson, infermiere. Suedia ka ashpërsuar ndjeshëm kontrollat kufitare. Sipas kryeministrit Stefan Lofven, verifikime shtesë do të kryhen në kufi përgjatë 20 ditëve në vijim, me qëllimin që bashkëpunëtorët e mundshëm të autorit të ngjarjes, të mos largohen dot nga vendi.





## Debati butaforik për çështjen e filmave shqiptarë, a duhen ndaluar me ligj

- Politika ambiguede dhe shqetësimet e mia si qytetar e njeri i letrave
- Cila është e vërteta rreth kësaj pasurie të madhe të artit filmor të Shqipërisë. Ku do të arrihej me një negativizëm absolut dhe arkaik. Si ka mundësi në Demokraci të gjallojë një ide e tillë e pakuptimtë? Cila është e vërteta rreth kësaj pasurie të madhe të artit filmor të Shqipërisë. Ku do të arrihej me një negativizëm absolut dhe arkaik. Si ka mundësi në Demokraci të gjallojë një ide e tillë e pakuptimtë?

NGA DR. MOIKOM ZEOO

faqet 14-15



► Beni ecen vete



► Lulekuqet mbi mure



► Tomka dhe shoket e tij

## ZHVILLIMI I QYTETIT

Elbasani i shek XVII, "nusja e Shqipërisë dhe e Rumelisë"

faqe 16-17



Shënime /Udhëtimi

## XHORXH FRED UILLIAMS

Ditari i ministrit amerikan në Shqipërinë e Princ Vedit

faqe 18-19





DEBATI | KINEMA



► Kapedani



► Tomka dhe shoket e tij



► Beni ecen vete

# Debati butaforik për çështjen e filmave shqiptarë, a duhen ndaluar me ligj

NGA DR. **МОИКОМ ЗЕГО**

**Cila është e vërteta rreth kësaj pasurie të madhe të artit filmor të Shqipërisë. Ku do të arrihej me një negativizëm absolut dhe arkaik. Si ka mundësi në Demokraci të gjallojë një ide e tillë e pakuptimtë?**

**1** . Është e pamundur të mos flasim për politikën. Politika shqiptare vuan nga sindromi i të papriturave dhe shpesh pakuptimshmërisë absurde.

Të tërë analistët, ose opinionistët mund të flasin për subjektet e shumëfishta të politikës, më tepër me hamendje, larg lëndës së saj, apo kulisave të mjegullta.

Kjo është arsyeja, që përgjithësisht, këto 26 vjet emrat e analistëve dhe opinionistëve, në vend që të shkëlqenin, përkundrazi janë ndryshkur, në vend që të bëheshin më të besueshëm, përkundrazi, janë bërë krejt të pabesueshme.

Ajo çka lexohet në shtyp, apo shfaqet në mediat elektronike është më tepër një botë virtuale, e gjyqimeve pa statusin e së vërtetës, të analizave ambikuide dhe të shpëllara.

Kështu që "këta brahmanë të opinionit publik" sipas shprehjes të mikut tim, prof. Fatos Tarifa, nuk arrin as t'i paraprijnë situatave, as t'i shpjegojnë situatat. Kjo buron veç të tjerave nga vetë paqartësia e politikës shqiptare.

Është e habitshme se sa e brishtë dhe sesa e palexueshme është politika shqiptare.

Në 2013 e majta shqiptare i fitoi zgjedhjet me 1 milion vota. Kjo përbën mazhorancë më të madhe nga tërë parlamentet në vendet e Europës. Në vend që kjo mazhorancë, që ndoshta s'do të arrihet më, të përdorej me guxim, në veprimet dhe vendimmarrjet politike të Kuvendit, qëndroi e plogët dhe jo efektive. Kurrë nuk e kam kuptuar pse ka ndodhur një gjë e tillë.

Shikoni se ç'ndodh këto kohët e fundit. Pa asnjë arsye të dukshme, pa as ndonjë sinjal paraprak, papritur Edi Rama i ndërron 4 ministra, ndër-kohë që zgjedhjet e përgjithshme parlamentare janë kaq afër, në një



► Shoku yne Tili

hapësirë kohore prej pak muajsh. Pse u bë ky ndërrim? Në një funksion më të lartë, të fuqizimit të PS-së? Nuk e besoj aspak këtë gjë.

Dy nga ministrat, Saimir Tahiri dhe Ilir Beqaj qenë më të kritikuarit dhe më të sharët nga opozita. Rama bënte, kinse, i mbronnte deri në fund këta dy ministra. Dhe befasi i zëvendëson duke krijuar dhe një precedent që ministrin e Brendshëm të ardhshëm, Fatmir Xhafaj, i cili ka luajtur rol në reformën në drejtësi, ta bëjë një shënjestër të gatshme, krejt të panevojshme, duke cenuar dhe reputacionin e këtij deputeti.

Dy ministrat e tjerë Klosi dhe Çuçi ishin normalë, gati të pakritikuar nga opozita. Po këta pse u hoqën? S'ka

asnjë arsye.

Arsyeja e arsyeve, si do të thoshte Don Kishoti, është se gjoja këta ministra u hoqën për të qenë koordinatorë për zgjedhjet e ardhshme politike.

Po këta koordinatorë janë me kredenciale të cenuara publikisht dhe politikisht. Ata mund të ishin koordinatorë edhe duke qenë ministra. Tani statusi i tyre është akoma më qesharak, ata nuk janë as deputetë, sepse ka qenë kusht që bërija e ministrit do të thoshte që të hiqte dorë nga mandati i deputetit (edhe këtë gjë nuk e kam kuptuar kurrë pse duhet të ndodhi!).

Por ç'do të bëjnë këta koordinatorë?

Pse koordinatorët janë gjithçka për organizmin e zgjedhjeve të përgjithshme politike? Ç'është ky koncept pseudoteorik që gjoja në një parti politike "pakica" mobilizon shumicën? Me një fjalë "motori i vogël" ndez motorët e mëdhenj.

Elektorati i majtë, që është më i madhi dhe më zotëruesi në Shqipëri ka nevojë të përfillet në bazën e tij dhe të jetë ai vetvetja dhe përcaktuesi i deputetëve të ardhshëm. Por ja që nuk është. Atij i vënë "dado" dhe i thonë "detyra jote sublimë është që të votosh emrat e listës së kryetarit".

Ky është mallkimi që vijon prej kaq vitesh mbi politikën shqiptare i ndryshimeve antikushtetuese të vitit 2008.

Prandaj jam shumë i shqetësuar si qytetar, si njeri i letrave duke parë se e majta shqiptare reflekton një çoroditje midis deklaratave pompoze dhe pasigurisë së veprimit, midis fantazmagorisë dhe realitetit. Heqja e ministrave të PS-së me të drejtë trumbetohet si fitore e opozitës. Kjo e ka stimuluar opozitën. E ka bërë më të motivuar. Nuk e kam menduar që mund të vinte një rezultat i tillë, që e theksoj, për mua është krejt virtual. Opozita kërkon qeveri teknike.

Unë nuk jam profet dhe as dëshiroj të jem profet. Por unë mund të bëj pyetje logjike dhe racionale. Po nëse Rama zbythet, tërhiqet dhe në një moment dobësie politike të pranohet edhe qeverinë teknike? Ç'do të ndodhë atëherë? Ky parashikim në konditat e rënduara mund të ketë shumë ithtarë. Natyrisht që një

qeveri teknike do ta komplikojë më shumë situatën politike.

Një qeveri teknike do krijojë pasiguri.

Qofsha i gabuar, por ndoshta mund të ndodhë çdo gjë për shkak, të paparashikueshmërisë time vetjake.

Gjithsesi e gjithë kjo katrahurë ndryshimesh të papritura, gjithë këto shpërbërje, mbështeten tek domosdoshmëria e një ndryshimi të ardhshëm radikal.

E kam thënë shumë herë, se dhe unë e mbështes këtë ndryshim radikal.

Nuk është fjala thjesht për "një Republikë të Re" siç qenë fjala vjen në Francë projekti i De Golit për "Republikën e V". Por që të ndodhë ky ndryshim i gjithanshëm, i tërësishtëm, duhet që tërë klasa politike e sotme shqiptare të anulohet.

Duhet kuptuar se establishmenti politik dhe politikanët shqiptarë këto 26 vjet kanë dështuar. Kjo ka ndodhur dhe në vende të tjera. Ka ndodhur në Itali, në Greqi, në Spanjë. Por mesa duket do të ndodhë edhe në Shqipëri.

Por kjo hamendje e bën politikën shqiptare akoma më të mistershme dhe që kërkon mendje të mëdha vizionare.

Kërkon politikanët të rinj, trima, të ditur dhe qëndrestarë.

2. Sapo kam dalë nga spitali i dashur Besim, ku mbarova ciklin e gjashtë të kimio terapisë. Mjekimet e mia ende vazhdojnë.

Gjatë ditëve në spital, kam ndjekur debatin e bujshëm, e stërkalshëm, butaforik, për çështjen e filmave shqiptarë të Kinostudios "Shqipëria e Re" që sipas idesë së Agron Tufës, apo dhe të ndonjë tjetri, duhen ndaluar me ligj.

Të mos transmetohen më. Pra të bëhet ndalimi përfundimisht në formë juridike i tërë kësaj pasurie të madhe të artit filmor të Shqipërisë.



# Politika ambiguidite dhe shqetësimet e mia si qytetar e njeri i letrave

**Në udhëkryqet e këtyre 26 viteve më shumë sesa dështimet në ekonomi dhe në politikë, Shqipëria ka dështuar në kërkimin e shpresës. Mallkimi që vijon prej kaq vitesh mbi politikën shqiptare i ndryshimeve antikushtetuese të vitit 2008**



Është hera e parë që bëhet një propozim i tillë delirant, me një negativizëm absolut dhe arkaik. Me një fjalë, tërë filmat shqiptarë të zhbëhen, të pluhurizohen, të kthehen në një Harresë dhe në një Amnezi absolute. Si ka mundësi në Demokraci të gjallojë një ide e tillë e pakuptimtë?

Demokracia bazohet mbi pluralizmin e ideve. Nuk ka përjashtime të ideve. Demokracia që përjashton idetë, qoftë dhe të kundërta, nuk është demokraci.

Mrekullia e Kushtetutës Amerikane është pikërisht Amendamenti i Parë, ku thuhet se nuk mund të persekutohet asnjëri për idetë dhe bindjet e tij politike dhe fetare. Mesa di unë është ky Amendament i Parë që përbën lirinë e patjetërsueshme dhe rinovimin e përhershëm dhe universal të Amerikës.

Kinematografia shqiptare është një shpikje e vonë e shekXX.

Shqiptarët janë të fundit që e krijuan "artin e shtatë". Më 1953, 8 vjet mbas Çlirimit të vendit, u ndërtua Kinostudio "Shqipëria e Re", me atelietë më të mëdha se çdo vend tjetër evropian. Filmi "Skënderbeu" me një subjekt të mirëfilltë dhe të jashtëzakonshëm shqiptar, që ka fituar dhe çmime ndërkombëtare, ka ndikuar në krijimin e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve si asnjë film tjetër. Për dijetarët e kinemasë, studiuesit profesionistë të filmit duhet thënë se filmi shqiptar përbën një substancë autentike.

Kinematografia shqiptare e krijuar nga regjisorë dhe aktorë shumë të talentuar, nga kompozitorë të muzikës së filmit tepër të njohur, përbën një nga thesaret e artit shqiptar tashmë në shekuj. Kjo kinematografi sipas disa studiuesve të huaj që kam mundur të lexoj, por që për momentin nuk po i citoj referencat e tyre, është kinematografi origjinale e krijuar si një sintezë midis traditës së filmit të neorealizmit italian dhe traditës së filmit modern rus, të forcës popullore, të ndryshimeve progresive, revolucionare, siç i konceptonte regjisorin gjeneral Ezenshtejni. Filmat shqiptarë kanë botën e tyre të artikuluar, kjo është bota shqiptare. Kinematografia jonë ndryshon, fjala vjen nga kinematografia jugosllave, bullgare, rumune, apo dhe hungareze dhe polake. Filmat shqiptarë janë mbështetur në temat historike dhe për shkak të popullaritetit të tyre të merituar të japin ndjesinë e një kinoditari real, si fjala vjen filmi "Nëntori i dytë". Ajo që të bën përshtypje të veçantë është se mjedisi, garderoba etnografike, struktura arkitektonike popullore të fshatit dhe të qyteteve shqiptare, të veshjeve të personazheve të krijojnë

idenë të një bote gjithashtu dokumentare, të papërsëritshme më, por që sot nuk ekziston.

Të gjithë filmat bazohen mbi dashurinë e pakufishme për atdheun. Asnjë film nuk bazohet mbi urrejtjen ndaj atdheut. Kjo është një pikë gravitacionale. E pashembullt.

Filmi shqiptar është organizuar nga regjisorë të përmasave të mëdha. I tillë është miku im, regjisori Dhimitër Anagnosti. Por edhe të tjerë nuk janë më pak. Për një rastësi historike apo për një domosdoshmëri historike mund të them se në këto filma luajtën artistë të mëdhenj, që sot kanë vdekur. Imagjioni! Duke i ndaluar filmat e tyre ne i vdesim për herë të dytë këta aktorë.

Asnjëherë muzika moderne shqiptare dhe profesioniste nuk ka pasur kaq shumë sukses sa muzika e filmave tanë. Në koleksionin e këtyre filmave ka pa dyshim, edhe filma të dobët, edhe stereotipe ideologjike, të cilat nuk mund ta dëmtojnë dhe ta prekin një shoqëri demokratike.

Urrejtja ndaj filmit shqiptar, si të gjitha urrejtjet e verbëta, është irracionale dhe e pashpresë. Kryqëzata për të ndaluar filmin shqiptar është e pakuptimtë sepse diçka e tillë paralele mund të bëhet dhe kundër shkrimtarëve të realizmit socialist, kundër koreografëve, kundër këngëtarëve, kundër piktorëve dhe

skulptorëve. Pyes: a nuk ekziston në Galerinë Kombëtare të Arteve ekspozita e pikturës së realizmit socialist? Pse nuk ngrihet dikush dhe të thotë "t'i djegim të tërë këto piktura"? Nëse duam t'i ndalojmë filmat, pse mos të ndalojmë dhe pikturat dhe këngët, dhe vallet, dhe librat e shkrimtarëve të shquar të realizmit socialist?

Kam në shtëpinë time një vëllim të plotë në anglisht të poemave të

pikërisht shqiptarët shpesh nuk e di pse nuk tregohen të kulturuar dhe normal në disa aspekte.

Në shekXVII poeti i madh anglez John Milton (1608-1674) autori i kryeveprës "Parajsa e Humbur" që përkrahës u revolucionarit republikan Oliver Kromuellit.

Kur ra regjimi i Kromuellit dhe u instalua regjimi mbretëror i Stjuartëve John Milton që vë në listën e atyre që duheshin dënuar me

vdekje, por Mbreti Stjuart i kohës, kur i sollën listën ogurzeze, ku ishte dhe emri i Miltonit tha në mëdyshje: "Se ç'ka kjo dora ime e djathtë që nuk do të firmosë!" Kështu Miltoni nuk u dënuar.

Kur u bë fushata për ndalimin e librave me pikëpamje të lira dhe krijimi i një censure mbretërore pikërisht ky Milton shkroi kryeveprën e tij të dytë, librin polemik nga më të rëndësishmit e

botës, të quajtur "Areopagitica".

Këtë libër dua ta lexojnë trundryshkurit dhe delirantët që kërkojnë të ndalojnë me ligj filmat shqiptarë. Emancipimi i shoqërisë bëhet në raport edhe me shijet estetike.

Emancipimi i shijeve estetike bëhet vetvetiu, pa dhunë dhe pa kallur në mendim "një xhandarmëri të mendjes" siç thoshte i paharruari Faik Konica.

3. Shqipëria është një vend që



► Lulekuqet mbi mure

Vladimir Majakovskit botuar në vitin 2012 në Amerikë.

Majakovski është poeti i revolucionit. Kur e mora librin në dorë mendova se shumë poema të tij revolucionare, për shkak të ndryshimit të epokave duhet të ishin hequr.

Por u habita kur pashë se në këtë përmbledhje ishte dhe poema e Majakovskit për Leninin. Dhe për lexuesin e kulturuar dhe normal kjo është diçka e vetëkuptueshme. Por



► Nëntori i Dytë

kërkon Shpresë.

E theksoj: Shpresa është konceptualitet. Nuk është një gjendje e thjeshtë humori. Shpresa është kauzë. Në udhëkryqet e këtyre 26 viteve më shumë sesa dështimet në ekonomi dhe në politikë, Shqipëria ka dështuar në kërkimin e shpresës.

Çfarë nuk kemi thënë për Shqipërinë. Kemi thënë se është një vend që nuk bëhet, gati një vend i mallkuar, një vend që nuk krijon dot shtet etj. Unë e kuptoj që në detaje të ndryshme ka elementë të së vërtetës.

Unë e kuptoj që Shpresa është një subjekt i shumicës. Pakica s'ka nevojë për Shpresë. Pakica ka nevojë vetëm për pushtet dhe fitime.

Por jam i bindur, ndaj u them shqiptarëve të mi, se brenda njerëzve të thjeshtë dhe popullit sythet dhe bërthamat e Shpresës janë, se Shpresa në fund të fundit është një kuptueshmëri. Se Shpresa është një vetëdije.

Ka ardhur koha që Shqipëria të kalojë Rubikonin e historisë. E ritheksoj siç e kam ritheksoar shumë herë se Shpresa simbolizohet dhe me funksionimin e Vettingut.

Vettingu nuk është një fjalë magjike. Vettingu nuk është shkopi magjik.

Por Vettingu është mundësia dhe instrumenti për të ndryshuar klasën e pandërgjegjshme politike, që parapolitikanët tanë t'i bëjmë politikanë të vërtetë, që populli të ketë përfaqësuesit e tij adekuatë dhe autentikë.

Në këtë aspekt ka rëndësi të madhe stimulimi i Shqipërisë shkencore dhe kulturore.

Nuk ka vetëm lajme politike në këtë botë, por ka dhe lajme kulturore të rëndësishme.

Lexoj në internet se miku im shkrimtari shumë i njohur francez Pascal Quignard sapo ka fituar çmimin e lartë letrar Andre Gide. Dhe u gëzova.

Por njëkohësisht u trishtova se këto ditë vdiq poeti, fituesi i çmimit Nobel Derek Ëalcott në moshën 87 vjeçare.

Është një poet i madh, social, me një metaforikë të jashtëzakonshme dhe për shumë kohë ka qenë poeti im më i preferuar.

Ai kishte miqësi me mikun tim, perkhyesit, Pirro Dollani, në SHBA dhe nëpërmjet Piroso i kam dërguar përshëndetjet e mia këtij poeti madhor të kohërave moderne.

Por ky poet që njihet në të gjithë botën nuk njihet në Shqipëri.

Kjo është një mangësi kulturore dhe artistike për ne shqiptarët.

Duke dashur për të gjallëruar mjedisin shkencor dhe kulturor të vendit, Akademia Shqiptare e Shkencave dhe e Arteve – që është një institucion alternativ i Akademisë së Shqipërisë organizoi një panel kumtesash në qytetin e Gjirokastrës ku morën pjesë akademikët Isuf Kalo, Mariglen Spiru, Ksenofon Krisafi, Fatos Tarifa, Emil Lafa dhe Moikom Zeqo.

Interesi i gjirokastriteve që shumë i madh. Unë fola për vlerat e patjetërsueshme të Gjirokastrës, kësaj ikone të trashëgimisë kulturore kombëtare dhe për mbrojtjen e këtyre vlerave ndaj çdo lloj projekti halucinant dhe anti shkencor.

Por në programin e saj Akademia Shqiptare e Shkencave dhe Arteve do të ushtrojë veprimtari edhe në qytete Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Durrës.

Sinqerisht më ka habitur interesimi dhe pjesëmarrja e njerëzve në kumtimet tona shkencore.

Edhe kjo gjë përbën një motiv të Shpresës.



ZHVILLIMI | I QYTETIT

NGA **EDUART CAKA**

**A.THEMELIMI I QYTETIT TË ELBASANIT**

Qyteti i Elbasanit u themelua në verën e vitit 1466 prej sulltan Mehmetit II mbi rrënojat e një vendbanimi të hershëm, Skampeis (Scampia, Skampini). Procesi i rindërtimit u bë nga ushtria osmane gjatë rrethimit të dytë të Krugës, ku burimet historiografike tregojnë se në krye të punimeve kishte qëndruar vetë sulltani duke i motivuar punëtorët që ta mbaronin ndërtimin sa më shpejt. Ky fakt pohohet edhe nga kronikat e kohës që bëjnë fjalë mbi ngjarjen në fjalë. Në përfundim ai ia vendosi emrin qytetit "Ilbasan", emër që reflektonte pozitën e rëndësishme të qytetit.

Një dokument i rëndësishëm në lidhje me ndërtimin e fortesës së Elbasanit, pozicionin gjeografik dhe rëndësinë që ajo kishte për osmanët është vetë letra e shkruar nga Sulltan Mehmeti II për djalin e tij Bajazitin ku ai shprehej: "për të siguruar pushtimin tonë mbi këtë vend, në një pikë, që na u duk më e përshtatshme, ndërtuam një kala madhështore, të pajisur me kulla të larta dhe mure e bedena të fuqishme. Këtë e caktuam si kryeqendër të vendit..."

Pozicioni gjeografik i qytetit të Elbasanit e bënte këtë të fundit një qendër me rëndësi strategjike. Qyteti ndërtohej në një pikë lidhëse midis pjesës veriore dhe asaj jugore të trojeve shqiptare. Gjithashtu, zona në fjalë përshkohej nga ruga e famshme Egnatia, e cila lidhte Romën me Konstandinopojën dhe që për shumë shekuj me radhë kishte qenë pikëkalimi i udhëtarëve, mbretërve, ushtrive e karvaneve tregtare të ndryshme. Kjo gjeografi përbënte një nyje të rëndësishme pikëtakimi për rrugët tregtare që bashkonin qytete me tregje të mëdha ekonomike siç ishte Ohri, Dibra, Durrësi apo Berati. Përveç rrjetit të brendshëm tregtar pozicioni i Elbasanit është përdorur edhe nga karvanet tregtare që merreshin me eksporte përmes portit të Durrësit. Të gjitha këto elementë favorizues përbënin një potencial të madh për zhvillimin e ekonomisë së qytetit ashtu edhe për shpërndarjen e prodhimeve të tij në një rrjet tregtar shumë të gjerë.

Me një largësi vetëm dyzet milje larg detit, Elbasani përbënte një rrezik të madh për pushtimin e Durrësit dhe pjesëve të tjera të bregdetit shqiptar që nuk ishin në duart e osmanëve. Për këtë arsye, pozicionimi i pushtuesit në një pikë kaq të afërt me brigjet e shqetësonte edhe Republikën e Venedikut, e cili sipas dokumentave ndërmori disa hapa konkretë për eliminimin e këtij rreziku potencial. Madje, dokumentat tregojnë se në gusht të vitit 1466 Senati i Venedikut merr vendim për t'u drejtuar Skënderbeut me qëllim ndërmarrjen e një ekspedite ushtarake të përbashkët për të penguar ndërtimet në Valm ku shkruhej: "Të gjithë ata që shkruajnë nga Shqipëria e quajnë si një gjë të rrezikshme e të dëmshme për shtetin tonë në Shqipëri, rindërtimin që po i bën Turku atij



# Elbasani i shek XVII, "nusja e Shqipërisë dhe e Rumelisë"

**Qyteti i themeluar nga sulltan Mehmeti II më 1466/ Ja si u shndërrua në një Qendër të rëndësishme ekonomike e kulturore e Shqipërisë së Shek. XVII...**

qyteti të quajtur Valmi, qoftë për afërsinë e tij me vendet tona, qoftë edhe për shumicën e materialit për të ndërtuar fustet dhe anijet e tjera dhe për lehtësi të zbrësë në për lum dhe të bjerë në det. Prandaj, duke qenë e nevojshme që të merren të gjitha masat e duhura nga çdo anë, të merret vendim që t'i shkruhet të madhërueshmit zotit Skënderbej, që të ketë mirësinë të marrë parasysh çështjen se ajo murtajë, që mund të thuhet se gjindet në gjirin e tij dhe tonin, do të bëhet çdo ditë më e dëmshme dhe më e rrezikshme. Gjithashtu, le t'u shkruhet proveditorëve tanë të Shkodrës dhe të Shqipërisë, se për këtë çështje duhet të takohen me Skënderbeun e lartpërmendur dhe t'i kuptojnë mendimet e tij, dhe t'i kujtojnë atij se do të na pëlqejë shumë dhe do të mbetemi fare të kënaqur në qoftë se ai merr guximin... dhe, pasi të mbliiden të gjithë njerëzit tanë vendas dhe italikë, këmbësorë e kalorës, bashkë me të gjitha trupat ushtarake tia... të mund të sulmohet ai vend dhe, pasi të zbohen turqit, të rrënohet..." Po në një dokument tjetër, dogu i Venedikut Moro i shkruan Pal Engjëllit duke i kërkuar këtij të fundit të bashkojë forcat me Skënderbeun, për të sulmuar qytetin "Valma" që ishte restauruar nga turqit dhe ta rrënojnë përfundimisht atë.

Si një pikë lidhëse e rrugëve tregtare Elbasani arriti një zhvillim të madh në një kohë shumë të shkurtër. Studiuesit por edhe kronistët e kohës theksojnë brenda një shekulli Elbasani arriti të bëhej njëra ndër qendrat ekonomike më të zhvilluara të vendit. Kështu, albanologu kroat Shuflaj citon një italian i cili e viziton qytetin në vitin 1570 duke e përshkruar atë me këto fjalë: "qyteti shtrihet në një fushë me ujë të bollshëm, ka mure të forta, pirgje katërkëndëshe dhe një hendek; rreth e përqark ka shumë lagje të jashtme. Për t'u dalluar nga qytetet e vjetra të Shqipërisë, frankët e quanin atëherë "Terra nuova", grekët Neokastro." Në këtë kontekst vlen të citohet dëshmia e ambasadorit venecian Bernardo i cili në vitin 1591 theksoonte se në Elbasan ishte selia e sanxhakbeut. Veç të tjerash ai dëshmon për ekzistencën e një tregu lëkurësh e leshrash dhe të dy karvansarajesh në qytet. Pra, në një distancë të shkurtër kohore prej vetëm një shekulli Elbasani kishte nisur të merre pamjen e një qendre të rëndësishme ekonomike, administrative e kulturore krahasuar me qytetet me të cilat rrethohej.

**ZHVILLIMI EKONOMIK, DEMOGRAFIK DHE KULTUROR I QYTETIT**

Të dhënat burimore tregojnë se

në shek. XVII qyteti i Elbasanit ishte njëra ndër qendrat më të rëndësishme të trojeve shqiptare me 28 lagje e mbi 4000 shtëpi duke kaluar kështu qendra të mëdha të kohës si Beratin, Shkodrën apo dhe Prizrenin. Kjo dëshmohej nga udhëtarë të ndryshëm që kanë vizituar zonën gjatë periudhës në fjalë, nga regjistrat osmane të kohës por edhe relacione të ndryshme që gjenden në arkivat perëndimore. Në lidhje me këtë të fundit, vlen të përmendet një relacion që dërgonte peshkopi i Stefanisë Nikolla Mekajshi për papa Klementin VIII ku theksohej se Elbasani ishte njëra ndër provincat më të rëndësishme të Shqipërisë. Letra e cila i përket shek. XVII e cilëson qytetin si qendër sanxhaku, me një popullsi të madhe ku vetëm pjesa e varoshit kishte rreth shtatë mijë shtëpi.

Çelebiu e tregon Elbasanin si qendër të sanxhakut, me një administratë të fuqishme dhe që kishte nën varësi zona të rëndësishme përreth ku mund të përmenden Bashtova, Myzeqeja dhe Durrësi. Me 526 katunde, 18 zeamete dhe 128 timarë Elbasani në shek. XVII rezultoi si një qendër e fuqishme ekonomike e administrative. Përsa i përket përmasave të qytetit Çelebiu rrëfen se vetëm brenda fortesës ndodheshin 460 shtëpi. Bashkë me lagjet që

gjendeshin në periferi që sipas tij shtriheshin deri në një orë larg, Elbasani kishte 1150 saraje dhe shumë shtëpi të nivelit mesatar.

Shkaku kryesor i rritjes ekonomike në një kohë të shkurtër ishte pozicioni gjeografik i qytetit i cili kryente funksionin e një nyjeje lidhëse midis Lindjes e Perëndimit, veriut e Jugut të qyteteve shqiptare. Studiuesit theksojnë se përveç tregut të brendshëm ku pazari i Elbasanit thihnte prodhimet e qyteteve të tjera të zonës së Shqipërisë së Mesme, ky treg lidhte gjithashtu edhe portin e Durrësit me Maqedoninë dhe Thesalinë, por edhe me tregje më të largëta si ai i Sofjes apo Stambollit. Pozicionimi mbi rrugën e vjetër Engatia i jepte mundësi tregtisë të prodhuar në Elbasan të lidhej si me tregun e brendshëm të perandorisë që kulmonte në kryeqendrën e saj Stambollin, ashtu edhe të paraqiste produktet e veta në detin Adriatik përmes portit të Durrësit. Një fakt tjetër i rrjetit të gjerë tregtar që qyteti i Elbasanit kishte gjatë kësaj periudhe është edhe prania e tregtarëve të huaj herë pas here në këtë treg. Kështu, të dhënat burimore tregojnë për ardhjen në këtë qytet të tregtarëve grekë, armenë, hebrej e të kombësive të tjera.

Një element tjetër tregues i rritjes ekonomike të Elbasanit ishin edhe panairët vjetore në të cilat



ekspozoheshin prodhimet e zonës. Ndryshe nga shumë qytete të tjera, Elbasani ishte ndër të paktat zona që zhvillonin tre panairë lokale në vit: panairi i Shën-Gjon Vladimirit që mbahej më 22 maj, i Shën-Ilisë më 20 korrik dhe i Shën-Mrisë më 15 gusht. Ky aspekt, ishte një tregues tjetër i rritjes ekonomike dhe potencialit tregtar që Elbasani kishte arritur gjatë periudhës në fjalë, ku, përveç kapacitetit prodhues të brendshëm ai thithte edhe prodhimet e qyteteve të tjera përreth si Kavaja, Durrësi e Kruja por edhe qendrave më të largëta siç mund të përmendet Berati, Dibra apo Manastiri. Duke patur parasysh faktin se zona e Elbasanit me fshatrat përreth ishte e favorshme për zhvillimin e blegtorisë, dy panairët e parë që zhvilloheshin në maj dhe korrik kishin më shumë një karakter bujqësor e blegtoral ku paraqiteshin prodhimet e zonës. Ndërsa panairi i tretë i cili zhvillohej në muajin gusht ishte më i madh dhe aty tregtoheshin mallrat e esnafëve. Për këtë arsye, panairi i tretë pritej me festime nga ana e korporatave.

Veç panairëve që karakterizoheshin nga një pjesëmarrje më e gjerë në Elbasan mbahej edhe tregu javor që zhvillohej çdo të dielë. Sipas udhëtarit osman Evlia Çelebiut këtë ditë qyteti mbushej me njerëz që vinin nga katundet, krahinat e fortesat përreth. Ai thekson se pjesëmarrja në treg është aq e madhe ruza mezi çahet për të kaluar. Me rëndësi është edhe përshkrimi që ai u bën rrugevë të qytetit duke theksuar se ato ishin të shtruara me kalldrëm ku në të dy anët kishte rrugë të posaçme për këmbësorë dhe në skaj të tyre gjendeshin kanale apo vija uji të cilat shërbenin për të larë, pastruar e flladitur rrugët.

Përveç pozitës gjeografike, një faktor tepër i rëndësishëm që i dha zhvillim të madh qytetit të Elbasanit gjatë kësaj periudhe padyshim ishte edhe institucioni i esnafëve ose korporatat. Organizimi i tregtareve të të njëjtave zeje në korporata ishte një motor i rëndësishëm zhvillimi si për vetë esnafët ashtu edhe për qytetin ku ato bënë pjesë. Gjurmët më të hershme dhe embrionike të organizimeve esnafëve në Elbasan datojnë që në vitet 1580 ku bëhet fjalë për disa profesione më të zhvilluara siç mund të përmenden ato të tabakëve, papuçinjve, shpataxhinjve leshpunuesve, etj. Pas fazës së formësimit esnafet do ta arrijnë kulmin e zhvillimit të tyre në shek. XVII duke funksionuar brenda një sistemi të kodifikuar. Bie në sy fakti se sistemi i esnafëve të Elbasanit rezultoi të jetë njëri ndër më të hershmit si në hapësirën shqiptare, ashtu edhe në pjesën ballkanike të perandorisë osmane. Kështu, statuti i tabakëve daton në vitin 1657, ai i argjendarëve më 1662 dhe ai i gëzoftarëve në vitin 1669. Ato ishin të organizuara në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, me statute e rregullore të veçanta, me përgjegjësi e detyra edhe në jetën qytetare. Çdo korporatë kishte drejtuesit e saj por edhe barjakët (flamurët) si shenjë dalluese. Duhet theksuar se korporatat nuk ishin vetëm angazhim i popullsisë myslimane. Në qytete të ndryshme kemi raste kur esnafe të ndryshme si ato të bakërxhinjve apo kujumxhinjve (argjendarëve) ishin të komuniteteve të tjera fetare. Në rastin e Elbasanit, mund të thuhet se kishte një traditë të rëndësishme të esnafëve ortodoksë kodikët e



të cilëve miratoheshin nga mitropolitë lokale.

Sa u përket korporatave që vërehen në qytetin e Elbasanit gjatë periudhës në fjalë, mund të thuhet se ai ishte qendra më e madhe shqiptare e esnafëve me 30 të tilla në të cilat përfshiheshin mbi 60 zeje të ndryshme. Në këndvështrimin tonë, ky aspekt përbën njërin ndër shkaqet themelore të zhvillimit të qytetit të një periudhe kaq të shkurtër dhe kulmimit të kësaj zone në shek. XVII duke u kthyer në njërin ndër qendrat më të rëndësishme të hapësirës shqiptare në aspektin ekonomik, administrativ e kulturor. Për ta bërë më të qartë rolin dhe peshën që esnafet kishin në jetën sociale dhe ekonomike të qytetit, duhet theksuar se drejtuesit e këtyre esnafëve në të njëjtën kohë ishin edhe pjesë e aristokracisë së Elbasanit.

Zhvillimi demografik dhe ekonomik i qytetit u shoqërua edhe me ndryshime në aspektin kulturor. Sigurisht që një shkak tjetër që ndikonte në formësimin kulturor të qytetit gjatë kësaj periudhe ishte edhe besimi i ri, Islami. Elementë kulturorë të motivuara nga besimet myslimane dhe ortodokse do të kenë influencë në objekte të ndryshme si objektet e kultit, afresket e kishave e të bazilikave dhe lëvrimin e artit gojor ku në Elbasan dëshmohej për praninë e poetëve të ndryshëm. Kështu ne hasim në aktivitetin e Onufër Neokastritit i cili jetoi në shek. XVI duke e vulosur stilin e tij në shumë kisha kryesisht në Berat dhe Elbasan.

Kronisti i famshëm turk i shek. XVII Evlija Çelebi është një tjetër autor i cili na jep të dhëna mbi qytetin e Elbasanit gjatë shekullit në fjalë. Ai e quan Elbasanin si "Daru'sh Shuara" që do të thotë vendi ose shtëpia e poetëve. Ky aspekt nxjerr në pah edhe anën e zhvilluar kulturore e veçanërisht poetike të këtij qyteti. Të rëndësishme në këtë përshkrim gjithashtu janë edhe aspekte të ndryshme të qytetit si lagjet, arkitektura, vende ose ndërtesa të rëndësishme, tregu i qytetit, figura dhe familje të njohura të kohës etj. Nga të dhënat që Çelebiu jep rreth qytetit mund të veçohet ekzistenca e tre instituteve bamirëse për të varfërit e të huajt, shkollave të ndryshme, shtatë kafehane, tri banja, 430 kroje e shumë puse.

Ai gjithashtu jep të dhënat mbi tiparet, veshjet e zakonet e banorëve të Elbasanit duke i cilësuar si njerëz të shëndetshëm. Çelebiu dëshmon se gjuha e përdorur në qytet është arbërishtja, njihet edhe turqishtja, ndërsa tregtarët dijnë edhe greqisht e frengjisht. Atij i bën përshtypje bukuria e qytetit por edhe e banorëve të tij. Për këtë Çelebiu e cilëson qytetin e Elbasanit si "nusen e Shqipërisë dhe të Rumelisë."

### ROLI I VAKËFEVE NË ZHVILLIMIN E ELBASANIT GJATË SHEK. XVII

Njëri ndër faktorët që ndikuan pozitivisht në përmirësimin e infrastrukturës, ekonomisë, mirëqenies dhe shërbimeve sociale ishte edhe institucioni i vakëfeve, thënë ndryshe fondacioneve të bamirësisë. Qytetet paraqesin ndryshime nga njëra tjetra duke u spikatur në sajë të disa avantazheve që mund të jenë gjeografike, kulturore, ekonomike apo administrative e strategjike. Kështu, gjatë kësaj periudhe Elbasani del në qendër të vëmendjes për zhvillimin e aspektit tregtar, konkretisht sistemit të esnafëve. Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se në dokumentat e shumta që kemi mundur të konsultojmë

në Sherijet e Elbasanit që gjenden pranë Arkivit Qendror të Shtetit vërehet se një pjesë e madhe e vakëfeve kishin lidhje të drejtpërdrejtë me këtë kategori.

Në vetvete esnafet kishin edhe vakëfe me anë të të cilave mund të kontribuonin për ndërtime objektesh kulturi, për ndihmesën e shtresave të ndryshme shoqërore që ishin në nevojë, për rregullime apo meremetime rrugësh, çezmash apo kanalesh. Kështu, nga dokumentat mësojmë se pothuajse të gjitha esnafet që vërehen në qytetin e Elbasanit kanë vakëfet e tyre. Shumica e të dhënave janë në lidhje me korporatat të cilat kishin më shumë anëtarë siç mund të përmenden ato të terzjive, tabakëve (lëkurëregjësve), shpatandreqësve etj. Kështu, janë të shumtë personat të cilët japin donacione në favor të vakfit të esnafëve pjesë e të cilës ato vetë ishin. Kontributi i vakëfeve në ndërtimin e objekteve të ndryshme por edhe si pasojë e rëndësisë së tyre në jetën ekonomiko-sociale të qytetit vërehet edhe në toponimet e shumta që kishin lidhje me këtë grup. Për shembull në Elbasan hasim në emra vendesh apo objektesh si pusi i tabakëve, shatervani i tabakëve, teqeja apo tyrbja e tabakëve, sheshi i tabakëve etj. Madje, vetë njëra ndër lagjet më të mëdha të qytetit kishte emrin Tabakhane, aspekt i cili e tregon më së miri rëndësinë dhe peshën që ky esnaf kishte në Elbasan.

Duke patur parasysh karakterin e fortë ekonomik të Elbasanit vlen të veçohet se edhe ky aspekt pasqyrohet në pronat që vakëfet kishin. Kështu, regjistrat e gjykatave tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e pronave të lëna në formën e vakëfit konsistonin në objekte që kanë të bëjnë me tregtinë ku shumica janë dyqane, prona të përbashkëta të korporatës por edhe objekte të tjera si hane apo hamame. Për shembull vakëfi i një personi të quajtur Husrev nga qyteti i manastirit kishte patur nën pronësinë e tij një hamam në pjesën e tregut në Elbasan. Regjistrat tregojnë se pas nxjerrjes në ankand hamami është marrë nga një person i quajtur Hysen me profesion hamamxhi për një vit me qera kundrejt shumës së 1800 akçeve.

Institucioni i vakëfit në periudhën osmane hasej në të gjitha

pjesët e shtetit osman dhe nuk kishte ndonjë limitim në mënyrën e të dhuruarit. Kështu një funksionar i cili jetonte në Stamboll ose në ndonjë pjesë tjetër të perandorisë mund të linte vakëf në vendlindjen e tij apo në vendin ku ushtronte funksionin e tij si zyrtar. Një figurë që mund të tregohet si shembull në këtë kontekst është edhe arkitekti i njohur osman me origjinë shqiptare Kasemi i cili ka ndërtuar vepra të rëndësishme arkitekturore si në trojet shqiptare ashtu edhe në pjesë të tjera të perandorisë. Kështu, mësojmë se arkitekt Kasemi në vitin 1641 ka kthyer në vakëf çifligje, banja, çezma, e prona të ndryshme në sanxhakët e Vlorës dhe të Elbasanit. Po ashtu, Hajdar pasha, një funksionar i lartë në ushtrinë osmane me origjinë nga një fshat i Elbasanit ka lënë një vakfije me anë të së cilës ai ndërton në fshatin e lindjes një xhami dhe një shkollë. Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre ai ka ndërtuar edhe një vakëf.

Një fushë tjetër e rëndësishme tek e cila shkonin kontributet dhe të ardhurat që fitonin nga vakëfet ishin edhe institucionet e besimit. Duke patur parasysh influencën që besimi kishte në jetën personale dhe komunitare të kësaj periudhe vërejmë se në vakfijet e shumta dhurohet edhe për këto institucione ku veçanërisht spikasin teqet. Në vetvete ky element mbart dy shpjegime. I pari ka të bëjë me përhapjen e rrymave mistike islame në Elbasan. Ndërsa aspekti i dytë ka të bëjë me impaktin dhe rolin që baballarët e teqeve kishin në hierarkinë e korporatave të ndryshme që ekzistonin në këtë qytet.

Duke u nisur nga të dhënat e mësipërme vërejmë se vakëfet në qytetin e Elbasanit gjatë shek. XVII. paraqesin disa komponentë të rëndësishëm që luanin rol në zhvillimin e jetës sociale, kulturore dhe ekonomike të qytetit. Roli social i vakëfeve konsistonte në ardhjen në ndihmë të shtresave në nevojë përmes shërbimeve që vakëfet jepnin. Ndërtimi ose mirëmbajtja e rrugëve, çezmave, shkollave dhe objekteve të kultit u jepnin mundësi banorëve të qytetit të përfitonin nga shërbimet e dhëna përmes tyre. Nga ana tjetër shtrësata e pasur solidarizohej në jetën qytetare me anë të dhurimeve në formën e pasurive të patundshme apo atyre financiare duke hapur kështu edhe vende të reja pune duke patur parasysh faktin se ishin njerëzit ato që do të punonin për mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e vakëfit. Padyshim që një rol të rëndësishëm vakëfet luajtën edhe zhvillimin ekonomik të qytetit dhe të esnafëve në veçanti. Vakëfet e secilit grup esnafor në njërin anë përdoreshin për ndërtimin e veprave në të mirë të shoqërisë por nga ana tjetër funksiononin edhe si kapital i përbashkët (bankë) ku esnafët mund të shkonin e të tërhiqnin të holla në raste nevojë. Të pasurit e një sigurie financiare i stimulonte pjesëtarët e esnafëve të investonin në zgjerimin e aktivitetit të tyre.

Nisur nga potenciali ekonomik, pozita gjeografike, zhvillimi urban e kulturor, aspekti njerëzor e filantropik Elbasani lulëzoi me të vërtetë në këtë periudhë. Bukuria natyrore e qytetit e bashkuar me punën e palodhur të tregtarëve dhe bujarinë e filantropëve i dha qytetit një pamje krejt tjetër. Po, Elbasani në këtë kohë ishte "nusia e Shqipërisë dhe e Rumelisë."

**Nisur nga potenciali ekonomik, pozita gjeografike, zhvillimi urban e kulturor, aspekti njerëzor e filantropik Elbasani lulëzoi me të vërtetë në këtë periudhë**



SHËNIME | UDHËTIMI

**K**ëto janë shënimet e një diplomati amerikan në Shqipërinë e 1914-ës. Përmbajnë gjykimin e një të huaji mbi Shqipërinë. Ai e krijoi këtë vetgjykim duke qenë një periudhë kohe të rëndësishme në kontakt me shqiptarët e duke parë me sytë e tij çdo gjë që ka shkruar.

"Shqiptarët" është një tablo mbi prejardhjen e këtij populli, mbi rrënjët pellazgjike, traditat dhe kultet, mbi sundimin turk në Shqipëri, i cili e nxorri Shqipërinë në gjendje tejte mjeruese në fillimshkullin e XX-të, por mbi të gjitha për atmosferën, porapaskenat, dëshmitë dhe personazhet e kohës kur në krye të Shqipërisë erdhi princ Vidi.

Autori i këtyre mreshtave Xhorxh Fred Uilliams më 1914 ishte Ministri i Amerikës në Greqi dhe në Mal të Zi dhe vëzhgues i Komisionit Ndërkombëtar në Durrës, komisioni i cili do të udhëhiqte dhe do të bashkëpunonte me qeverinë e Vidit. Por siç shkruan përkthyesi i këtij libri në vitin 1934 Shaban Balla, zoti Uilliams e pa të pamundur bashkëpunimin me tyre. Ai kuptoi se punët po shkonin mbrapsht, marrëveshja e Londrës e kishte mbjellë shumë ters farën. Pas shumë mundimesh për marrëveshje sa me kryengritësit e Shqipërisë së mesme, sa me ata të Jugut, Uilliams u bind se këto punë ishin të kota dhe vendosi të marrë një masë të fundit. Shkoi në Shqipërinë e Jugut ku arriti një marrëveshje mes "epirotëve" kryengritës dhe vlonjatëve që të bashkoheshin e të shpallnin pavarësinë e tyre. Ai kishte si qëllim që sapo të zhdukej qeveria e Vidit e cila doemos nuk kishte jetë të gjatë, t'i bashkonte kësaj pavarësie edhe pjesën e sipërme të Shqipërisë. Por shumë shpejt këtë marrëveshje e përmbysën diplomatët e Europës, të cilët dërguan në Vlorë dy luftanije që përmbanin anëtarë të komisionit të Durrësit. Ata e ndaluan këtë bashkim. Atëherë Uilliams e kuptoi se marrëveshja e Londrës kurrësesi s'kishte qëllim të krijonte një Shqipëri të lirë.

"Kësisoj ai vendosi ta lërë këtë skenë mëkatësh, por njëherazi edhe të shfaqë publikisht "komedinë tragjike dhe shpirtin e zi të diplomacisë Europiane", shkruan Balla.

Një libër i rikthyer në libraritë shqiptare para disa viteve sipas botimit të parë të '34-ës, "Shqiptarët" është një vepër që vlen mjaft t'i rikthehesh kohë pas kohe. Sot nga ky libër do të botojmë një pjesë nga kapitulli "Rënia e qeverisë së Vidit".

AD.PE

**KUSH ËSHTË**

Xhorxh Fred Uilliams (1852-1932) lindi në Dedham të Masaçusetsit. U arsimua në degen e ligjeve në Masaçusets më 1872 dhe pas studimeve të tjera u bë avokat. Gjatë viteve 1880-1887 kreu redaktime të botimeve të rëndësishme ligjore në vitet. Më



# Xhorxh Fred Uilliams

## Ditari i ministrit amerikan në Shqipërinë e Princ Vidit

**Ditët dhe orët e një vëzhguesi amerikan në Shqipërinë e 1914-ës. Ambasadori i SHBA-së në Greqi e Mal të Zi në vitet '13-'14 shkruajti një varg shënimesh mbi Shqipërinë e kësaj periudhe dhe shumë çështje, tradicione e të dhëna mbi prejardhjen e shqiptarëve... Shkëputur nga përkthim i vitit 1934, kapitulli "Rënia e qeverisë së Vidit"**



► Princ Vidi


1889, ishte anëtar i legjislaturës së Masaçusetsit dhe gjatë viteve 1891-1893 ishte anëtar demokrat i Kongresit Amerikan. Gjatë viteve 1913-1914 ishte Ambasador i SHBA në Greqi dhe Mal të Zi.

**PJESË NGA KAPITULLI "RËNIA E QEVERISË SË VIDIT"**

Mbërrita në Durrës me datën 18 Gershor. Gjatë një jave që kalova në Gjirokastër me kryetarët e kryengritësve unë pata mësuar për vrasjen e 70 mohamedanëve të pa armatosur, të cilën komisioni e kishte vërtetuar por kryengritësit e mohuan dhe e pata vurë vhten në dijeni me gjithë mosmarrëveshtjet që qëndronin në mes të "epirotasve" dhe komisionit ndërkombëtar për të bërë paqe. Unë jo vetëm që u habita, por edhe u tmerrova për ngatërresat që gjeta në Durrës. Secili anëtar i komisionit ishte me armë në dorë kundra tjetrit dhe në vend që të ndëgjonin lajmet e dobishme që solla unë, secili e shkonte kohën duke më përshpëritur në vesh gjërat pa mend dhe keqbërjet e tjetrit. Asnjëri nuk kishte as më të voglën ide se kush e kishte sundimin ose komandën më të lartë, e cila kërkohet me një farë autoriteti nga princi, nga komisioni, nga oficerët hollandezë dhe nga kabineti. (Sepse marrëveshja e Londrës e kishte zhytur këtë punë duke ia dhënë në njërën anë

komandën njërit e në një tjetër tjetrit, herë komisionit e herë Princit e herë oficerëve hollandezë – shën. përkth.)

Me i përshkruar hollësisht e ngatërresave që çdo ditë u bënë edhe më të këqija në Durrës, nuk do të ishte edhe aq e dobishme. Qeveria shkoi një herë në Vlorë dhe iu desh me u kthyer prapë në Durrës për arsye kompletoresh dhe aty gjeti kryengritjen e Esad Pashës. Një oficer italian u zu natën në Durrës duke i bërë shenjë kryengritësve e në këtë mënyrë duke iua drejtuar udhët e operacionit. Kur e arrestuan u gjet se ai që duke bashkëpunuar me oficerin që kish pas qenë ngarkuar me mision nga Princi për të mbrojtur Durrësin nga kryengritësit; atëhere misioni u pezullua. Një oficer hollandez më tha se Princit nuk mund t'i mbushej mendja kurrësesi për t'i prirë ushtrisë e as me u dukur më para luftës. Luftaniet e gjashtë fuqive rrinin në një qetësi të vdekur në port. Kur qyteti u mësye, komandantët e tyre u thirrën për të shtirë ca topa sa me trembur kryengritësit, por ato kundërshtuan duke thënë se kanë urdhëra të rrepta me vepruar vetëm për mbrojtjen e personit të princit e të familjes së tij. Kjo tregoi qartazi se fuqitë e mëdha kishin vendosur mos me shtirë asnjë top për mbrojtjen e qeverisë që kishin marrë përsipër me themeluar. Përvoja





## SHQIPTARËT

GEORGE FRED WILLIAMS

përkthyer nga Anglishtja prej

SHABAN BALLËS

ësia dhe e vortota nuk janë mbrojtje  
se arsye në Sallat e DiplomacisëDjali jem, ti nuk e din se me sa pak  
mëshirë qeveriset bota

TIRANË — Shtypshkronja "Dielli" — 1934

im e fundit në Durrës që një natë para se të largohesha, kur qeshë zgjuar prej një krisme të tmerrshme pushkësh në kënetë pothuaj nën dritaret e mia. Oficerët më lajmëruan në mëngjes se kishin dërguar nja 15 vetë nëpër kënetë për të kërkuar të vranë e të plagosur, por njerëzit e tyre duke i kujtuar këta se ishin armiku që po iu afrohet, shtine mbi ta dhe i vranë të gjithë. E lashë këtë skenë mëkatesh, ngatërresash të ndyra dhe gjakderdhjesh me një zemër plot mëri kundër krimit të madh të Europës dhe plot simpati për popullin që iu desh me derdhur gjak për të mbajtur larg zgjedhen dhe një nga gabimet më skandalozë në historinë e Europës. Tre muaj pas kësaj, princi, familja e tij, oborri e kabineti i tij, komisioni ndërkombëtar, ministrat e huaj, xhandarmëria dhe luftanijet ikën nga Durrësi dhe Shqipëria u la sikurse është sot, pa qeveri.

(Domethënë në kohën e Luftës I Botërore – shën. përkth.).

## MASA PËR SHPËTIM

Të nesërmen, pasi pata lënë Durrësin mbërrita në Vlorë. Kryetarët e Vlorës ishin besnike të princit Vid dhe i patën dhënë ushtarë për të luftuar kyengritësit e Shqipërisë së mesme dhe "epirotet" në Jug të Vlorës. Prandaj këta gjindeshin në një frikë të përditshme prej ndonjë mësymjeje nga vëllezërit e vet. Që mos të vazhdohej më rrënimimi në mes tyre, i këshillova që të shpallin pavarësinë dhe të bëjnë paqe me vëllezërit e vet. Në emër të tyre shkova në Delvinë dhe takova kryetarin e

qeverisë së perkohshme të Epirit, Zografo, i cili ishte i sëmure në zemër pasi po kthehesh nga varrimi i 14 djelmohave Delvinnjotë që sapo ishin vranë në shpat të malit, ndërsa 40 burra shtriheshin të plagosur. Ai që gati me bërë paqe me vlonjatët dhe kur ky lajm mbërriti Vlorën u prit me shumë kënaqësi dhe duar-trokkitje. Atë mbasdreke dy luftanije të fuqive të mëdha që bënin pjesë në komisionin ndërkombëtar, u ngulën në port dhe nën hijen e topave të Europës nuk lejuan bashkimin që unë kisha parash-truar. Ata e dinin mirë që qeveria e tyre po kotesh mbi fronin e saj dhe se do të binte.

Po ashtu e dinin që përmbajtja e veprave të tyre do të shkaktonte edhe më shumë gjakderdhje vllazërore. Prej asaj kohe e mbrapa fuqitë "epirote" dhe kryengritsit e Shqipërisë së mesme përparuan. Më tepër se 100 000 barinj dhe bujq, gra, burra, fëmijë dhe foshnje lanë shtëpijat e tyre, të cilat ua dogjën e ua shkatërruan dhe këta vetë emigruan në Vlorë. Kur unë u largova nga Greqia, sëmurdja e lisë po përhapej nëpër këta emigrantë që pa ndihma dhe pa shpresë vdisnin në qarkun e Vlorës. Pak mbas largimit tim, u raportua se nga këta 100'000 emigrantë 30'000 kishin vdekur urie dhe s'kishin as mbulesë e as kasolle ku me shtirë kryet. Jam informuar që nëpër gjithë Shqipërinë ka zi. Në pranverë nuk ka me patur misër për farë për ata që do të shpëtojnë.

## ZBULIMI I PADREJTËSISË

Mirë do ishte po ta kishte përshkruar gazeta Times e Londrës skenën e Durrësit si një komedi tragjike, që brenda pallatit mbretëror luheshin shakatë cinike më të mëdha, që mbrapa maskave buzëqeshëse të diplomatëve të Europës fshiheshin fytyrat e errta e kriminele, shkaktojnë të vdekjes së këtyre njerëzve, se jashtë në kënetë shtriheshin qindra Shqiptarë mbrojtës të vatrave të veta, të fortë e të ngrirë, me sytë e tyre dhimbisurisht të drejtuar kah qielli i cili dukej e pamëshirshëm për ta. Dukesh një detyrë njerëzore, haptazi, me shqyer maskën që mbulonte diplomacinë Europiane e me nxjerr fytyrën e saj të lyer me gjak atdhetarësh dhe shikimin e dobët të saj mbi dëshirat e zjarra për liri të një race të fortë. U ktheva në Athinë dhe pasi qeshë i shtrënguar e tregova këtë panjerzi dhe këtë padrejtësi të fuqive Europiane dhe dhashë dorëheqjen si ministër i Amerikës në Greqi e në Mal të Zi, sikurse patjetër qeshë i shtrënguar me bërë. Drejtësia dhe e vërteta nuk janë mbrojtje në sallat e diplomacisë!

Qe shorti im me ngri-tur perden që t'i jepja dritë kësaj komedie, e cila që loja më tragjike që është vu në skenë prej duarve të njerëzve. Ky veprim që ai që me ka hapur rrugën me iu lutur popullit të lirë të Amerikës të ndihmojë Shqiptarët që po mundohen me luftë e me vdekje për lirinë dhe pavarësinë e tyre. Kur Europa, e përgjakosur, e mjeruar, e shfarosur, e falimentuar dhe e këputur do të hyjë duke çaluar në një periudhë të re qytetërimi, atëherë le të mësojë prej vuajtjeve të veta mëshirën që duhet të ketë për kombin e vogël malësor; e cila dëfrehesh me shtërgimim e shpirtit e me britmat e vdekjes së tij dhe vepronte paturpësisht duke i quajtur asgjë tmerret dhe vuajtjet e këtij populli për liri dhe humbjen e lirisë të një populli e quante një sakrificë të zakonshme për qejfin e tyre

SHQIPTARËT  
KHORXH. F. WILLIAMS  
THE SHKYPETARS

## Nga shënimet e diplomatit Williams

## Historia e tmerrshme e Turqisë në Shqipëri

Kur kam folur për robërinë e Shqiptarëve nën Turqi, nuk kam patur në mendje mizori, tortura, vrasje dhe therje. Këto veprime bien mbi persona të veçuar të cilët vuajnë, vdesin dhe harrohen. Shkenca e torturës, thelbi i tiranisë dhe djallëzia e vrasjes janë në kulmin e tyre kur i drejtohen një grupi dhe shpirtit e jetës së një shteti. Duket si e pamundur që një qeveri të tregojë haptazi vendimin e vet për të shkatërruar lumtërinë e për të mohuar shpresat dhe dëshirat e një populli nën sundim. Por kjo është historia e tmerrshme e Turqisë në Shqipëri. Malësorët trima nuk u shtruan kurrë dhe shumica e tyre kundërshtuan edhe pagesen e taksave. Ata vdisnin në grupe pse rrinin së bashku për t'u mbrojtur nga mësymjet e herë pas herëshme të ushtrive turke, të cilave kurrë s'ia lëshuan shtëpitë e tyre. Por ata nuk mund të mbronin edhe fushat ku ishte mundësia më e madhe e përparimit dhe qytetërimin. Për Turqinë, fushat kishin dy vlera: e para si burim të ardhurash dhe e dyta për të mbledhur ushtarë. Popullit i vinin taksat të mëdha që i mblidhnin pa mëshirë. Taksat dërgoheshin në Turqi dhe shumë pak shpenzoheshin në vend. Në këtë mënyrë e ropi Turqia pasurinë e vendit. San Xhuliano, tani vonë ministër i jashtëm i Italisë, thotë se qyteti i Vlorës paguante 1'000'000 franga në vit dhe vetëm 20'000 shpenzoheshin aty. Gjithashtu edhe në Vilajetin e Janinës mblidheshin 9'000'000 franga, prej të cilave vetëm 2'000'000 shpenzoheshin për atë vilajet.

## MBLEDHJA E USHTARËVE

Por e ardhura tjetër ishte edhe më e vlefshme. Shqipëria nxirrte pothuaj ushtarët më trima në Europë. Malësorët Shqiptarë të lartë, të fortë e të pafrikshëm, përbënin gardën e Sulltanit. Mirditasit dhe malësorët përgjithsisht viheshin në pjesët më me rëndësi të ushtrive turke. Shumë prej tyre morën lavdërimi dhe pozita të larta si në ushtri ashtu edhe në administratë. Edhe në ditët e Romës pat qenë ideja për ta bërë Shqipërinë një fole për rritje dhe nxjerrje luftëtarësh, por Turqit e përmbushën këtë ide. Duhet shënuar se po të ishte Shqipëria e përparuar, e edukuar dhe e lumtur, nuk do t'i jepte ushtarë Turqisë. Për këtë arsye padituria, veçimi i saj nga bota e përparuar dhe varfëria u zgjodhën prej turqëve si vegla për të mbajtur

nën thembër këtë popull trim.

## COPTIMI I VENDIT

Siç duket, ishte vendosur në çdo fuqi mendore zhvleftësimi moral, intelektual, shpirtëror, ekonomik dhe politik i këtij populli. Zyrtarët që të gjithë ishin të pasjellshëm; të ashtëqjiturat salla të drejtësisë, gjyqet, nuk mbronin as persona as pasuri. Njerëzit viheshin në burg me dëshmirë të fshehta. Gjithë lëvizjet për bashkim prisheshin nga nëpunësit e pashpirt dhe gjithë masat për punë e industri pengoheshin nga tagrambledhësit. Mund të thuhet se këto janë kondita edhe në vende të tjera të nënurdhëruara, por jo kaq sistematikisht. Miniera ari patën qenë punuar prej Romakëve e argjendi prej venedikasve. Këto patën qenë mbyllur shumë kohë përpara me urdhër qeveritar dhe tani as vendi nuk u dihet. Pyje të mëdha shkonin më kot dhe kalbeshin për arsye ligjore dhe transportimi. Ndërsa në shtetet e tjera të Europës ka një endje të madhe hekurudhash, ky vend nuk ka asnjë rrugë hekurit prej Veriu në Jug. Fuqira të mëdha ujrash nuk përdoren; porte shumë të mirë janë pa mbrojtje dhe pa ndërtesa doganore. Lumenj, nëer të cilët duhej të lundronin avullore me transportuar lëndët e pyjeve në tregjet botëore, janë të vdekur e të padobishëm. Përveç ç'ka lanë Romakët, rrugë të tjera nuk ka; një njeri për të shëtitur prej begut në brendinë e vendit ose prej një qyteti në tjetrin, duhet të shkojë mbas gjurmave ose nëpër ndonjë rrugë qorre. Portet e sigurtë dhe hekurudhat do të ishin mjete për të bashkuar Shqipërinë me botën e jashtme dhe rrugët e gjëra do ta bënin të lehtë kalimin prej një qyteti në tjetrin. Por ndërldhje të tilla do t'i kujtonin popullit dobinë e qytetërimin dhe do të bëheshin shkak kundërshtimesh dhe kryengritjesh. Parimi i mallkuar për të mbajtur këtë vend të veçuar, si brenda me njëri-tjetrin ashtu dhe me botën e jashtme, ishte shkak që e la këtë vend të verbët e të errët, ndërsa nëpunësit e Turqisë mbushën botën e jashtme me propaganda mbi egërsinë e këtij populli dhe rreziqet e udhëtimit në këtë vend. Por historitë dhe shënime nuk tregojnë për ndonjë të huaj që u gjend ndonjë herë në rrezik në tokën Shqiptare; doemos ata që nuk prunë me vehte ndonjë komplot ose tjetër qëllim të keq për popullin. Përgjithësisht çmohet mikpritja e Shqiptarëve prej atyre të huajve sa më tepër që ata e vizituan këtë vend me qëllim miqsor. Në këtë tokë me fjalën qytet quajmë një vend që nuk ka më shumë se 40'000 banorë.



# Me të kuqe më vish , në këtë valle bore të bardhë

## PRANË SHËN FRANÇESKUT

Unë ec në pakuptueshmërinë e të bardhës,  
Nën erën që do të më kujtojë  
Se larg ka pranverë,  
Dhe se fishkëllimi mardhës,  
Do ndalë një herë,  
Pas përcjelljes së polenit në pistil.  
Dua t'i flas Shën Françeskut,  
Por ai edhe pse gjysëm i ngrirë,  
Veshur tebdil,  
Me të akulluara dantella,  
Korbave ju flet.  
Unë përulem,  
I pëshpëris në vesh,  
Ndërsa ai në të thella  
Me shenja ju bën drenushave të fshehura.  
Ti prët.  
Në qiellin e murrëtqyer të rikrijimit,  
Lajmin të sjellin patat e vëna varq,  
Kuntin e jetës që Shën Françesku më përcjell,  
Me qishtat e rreshkur dhe të ngrirë.  
Nuk do të jesh në errësirë,  
Edhe pse larg.

## VEHJA

Më higni teshat tërësisht zyrtare,  
Dhe do shihni shajak të shqyer nën to,  
Nga ku dallohet,  
Më thellë,  
Një larushane këmishë cigani,  
Për fat të keq jo mbi të lakurigtin gjoks,  
Por mbi një xhamadan të rhinstë,  
Kopsitur krejt,  
Sipër një të linjte kozaku.  
Veshje të gjithshkaje që kam dashur të isha,  
Dhe të jem nuk munda.  
Mbi trupin e drobitur të endacakut,  
Ende valëvitet këmisha,  
E asaj dite të largët të pagëzimit,  
Kur mëkatarin të vogël trup,  
Pasi e lanë,  
E mirosën në kisha,  
Me shpresë të shkante drejt shënjtërimit.  
Mos më shihni teshat që tash kam trupit  
puthitur!  
Në to,  
Eshtë i njëjti fajtor i pafajshëm,  
Krejtësisht cullak,  
Edhe pse më i rritur,  
Zë do më shumë se trishtimin,  
Në futyrë të mbajë buzëgëshjen.  
Ndaj mos më shihni ashtu si doni,  
Por ma çirni,  
Nga supet ma higni,  
Përfundimisht ma qrisni  
Veshjen!

## ME TË KUQE MË VISH

Ti thua: "Me të kuqe më vish ,  
Në këtë valle bore të bardhë  
Të feks mes rrëzëllimit të kristaleve,  
Si një shëmbëllim perish,  
Të Mesdheut të largët të dukem,  
Peritë që ngjiten majave mbi det,  
Duke kënduar,  
Shtatpërkundura në rradhë.

Mbi këmishë,  
Më pri një pjesë të ngjajë si zemër,  
Sa gjoksin që pëlgen të shohësh,  
Dy xinçifilet do të le t'i prekësh,  
E me dhelet e tua ti më tej të më joshësh.  
Më pas gjarri i shenjtë t'na përfs hijë,  
Si i ëmbli lëng që del hardhish,  
Të puthemi,  
Të dehemi,  
Të rreqëtimë;  
Të gjithën me të kuqe ti më vish!"

## GJITHËBLERËSIT

Në mesnatë erdhën  
Të më blinin shpirtin.  
Tju shihja futyrat kisha kureshtje  
Ata prisnin në të thellë heshtje,  
Sa ulente donin të dinin.  
E unë geshja si i marrë  
Me marrëzinë e tyre të errët,  
Me shpirtin tim që nuk ulente një dysh,  
Bërtisja: "Mu higni sysh  
Pjella të përdala skëterre!"  
Jashtë frynte era e dëshpërimit,  
Ajo që lulëzimin le në mes,  
Zë bën të klithësh der' në ngjirje,  
Të stërpërdorurën patetike thirrje  
"Shpirtin nuk e shes!"  
Cfarë blihej atë natë?  
Vetëm qjerat pa ulerë,  
Stolitë që nuk shiteshin,  
Lulet që përfundimisht uyshkeshin,  
Kërthijte ende pa lerë?  
Natë e shitblerësit terror,  
E matrapazëve të ëndrrave dhe arit,  
E xhambazëve të gjinjve të vënë,  
E kambistëve të fjalës "nënë",  
Treqëtarëve të jetës tej uarrit.  
"I joni është koleksioni i shenjtëriue:  
Ja- Përdëllimi i murgeshës;  
Ja- Soneti i bardit të verbër;  
Ja- Dashuria për birin e vetëm;  
Ja-Himeni i virgjëreshës.  
Të gjitha, të gjitha i blemë!  
Tonat janë deri në amëshim.  
Nuk ka asgjë që s'ka një ulerë,  
Zë shpejt a vonë në dorë mos na bjerë,  
E zhveshur nga çdo përkushtim!  
Ndërsa flisnin futyrat shqova,  
Sy të udekur që kurrë s'patën garë,  
Mbi buzët e holla dhëmbët e nxjerra,  
Zenie pa ngjyrë, tmerrësisht të mjera,  
Robër të koleksionit të tyre llahtarë.



Një cikël poetik  
nga Naum Mara



Një javë pas ndarjes nga jeta të këngëtarit Françesk Radi, bashkëshortja e tij Tefta Radi dhe familja po presin ngushëllimet në Hotel Mondial. Bashkëshortja e këngëtarit është e pikëlluar për humbjen e parakohshme, por edhe që i janë ndërprerë ditët më të mira që e prisnin pas rritjes së fëmijëve dhe telasheve që ka kaluar në jetë. Tefta Radi rrëfen për Report TV, njohjen në Fushë Arrëz dhe dashurinë me këngëtarin e internuar e të privuar nga jeta artistike në Tiranë. “Vitet e Fushë Arrëzit vërtetë vite të vështira. Isha vetëm 22 vjeç. Dilja për herë të parë nga shtëpia, në një terren të thyer me klimë të ashpër, por do të ishin dhe ditët më të bukura sepse u njoha me Frankun. Ai vajti direkt në Festivalin e 11, unë kam vajtur dy vite më vonë. Ishte një dashuri pa interes në një kohë kur shumë kush e përndiqte ose i thoshte do t'i biesh kitarës kur të të themi ne”, u shpreh Tefta Radi. Radi kujton edhe kontributin e Françeskut për ngritjen e orkestrës popullore të Fushë-Arrëzit. “Ndoshta një pjesë e njerëzve të emëruar nga partia ishin të detyruar të zbatonin urdhrat, por njerëzit e thjeshtë dhe disa pushtetartë e kanë dashur fort Frankun, sidomos ata që e kanë njohur nga afër dhe kanë pasur kontakte të ndryshme me të. Franku gjallëroi Fushë Arrëzin, gjallëroi fëmijët e Fushë Arrëzit, u mësoi kitarën dhe vetë mësoi instrumentet e veriut. Bëri një punë të vyer bashkë me Ndue Shytin në krijimin e Orkestrës së Veglave Muzikore Popullore”, tha ajo. Familja Radi ka ndarë në orët e hidhura të humbjes së njeriut të tyre të zemrës Françesk Radit, bashkë me kujtimet që artisti ka lënë pas. Aktorja Margarita Xhepa ka kujtime të pashlyeshme për këngëtarin. “Është një humbje e madhe jo vetëm vetë për Frankun që ishte relativisht i ri dhe kishte çfarë të jepte prapë për familjen, por dhe për shoqërinë dhe muzikën”, tha Xhepa. Pritja e familjes për ngushëllime ka filluar të premtën pas orës 16.00 ndërsa do të ketë pritje edhe të shtunën e të dielën. Këngëtarin e njohur Françesk Radi ka ndërruar jetë në 3 prill të këtij viti në moshën 68-vjeçare. Për këngëtarin u mbajt



Tefta dhe Françesk Radi



Tefta Radi

# TEFTA RADI:

## Çfarë ndodhi me Frankon pak ditë para se të shuhej

Bashkëshortja rrëfen për njohjen në Fushë Arrëz dhe planet që për të ardhmen

një ceremoni madhështore për përcjelljen në banesën e fundit në datën 4 prill, ku zonja Radi u shpreh se e ka dashuruar Françeskun kur të tjerët kishin frikë t'i flisnin me gojë. Bashkëshortja Tefta Radi rrëfen jashtë kameras, se ikja e papritur e Frankos, siç i thotë ajo, ka ndërprerë ëndrrat më të bukura. “Kishim planifikuar të shkonim në Australi për të jetuar aty përgjithmonë. Aty kam prindërit dhe Franko kishte gjetur punë në një kishë ku do i

binte pianos. Kishim marrë vizat dhe premë biletat. Pranim që unë të mbarojë projektin me një dokumentar dhe ai do të jepte një koncert të vogël. Me shume nga te gjithë ishte i gezuar Franko. Me tha, ‘Tefta, tani do shijojme pak jeten tone’. Madje në shtëpi kemi dhe pianon me partiturat hapur siç i la Franko, një ditë para goditjes fatale nga hemorragjia”. Edhe pse ajo thotë që nuk është supersticioze, nisi të besojë në këtë që në çastin që ora e murit ngeli në

kohën kur Franko ndërroi jetë. “Ora në mur ngeli 3 e 15 minuta. Ora ngeci kur Franko ndërroi jetë. Nuk kam për ta rregulluar kurrë. U kam lënë amanet fëmijëve që atë orë ta ruajnë ashtu, si moment lamtumirë”. Françesk Radi ndërroi jetë me 3 Prill në spitalin “Nënë Tereza” në Tiranë, në moshën 67-vjeçare. Këngëtarin e mirënjohur ishte shtruar në gjendje kritike për jetën prej një jave në reanimacionin e QSUT, pas një hemorragjie cerebrale.

### Panairi

## Dibra, Mati dhe Klosi prezantojnë trashëgiminë kulturore

Një panair me vlerat e trashëgimisë kulturore dhe etnografike të zonës së Dibrës, të Matit e Klosit është çelur këtë të shtunë në Tiranë. Në sheshin “Avni Rustemi”, pranë tregut, artizanët e këtyre trevave kanë sjellë punimet e tyre, si dhe prodhimet bujqësore e blegtorale, duke shpalosur artin e shijen tradicionale të trashëguar në shekuj. Dhjetëra këngë e valle folklorike janë shpalosur nga të rinjtë e zonave më të thella të këtyre trevave. Grupi mae vajza dhe djem të rinj kanë ardhur nga Guri i Bardhë, ish qytet i vjetër i Arbërit, i njohur nga të huajt si Petralaba. Këtu ka qenë rezidenca e Skënderbeut dhe Kalaja e tij. Kjo zonë është e njohur në histori për traditat e saj të veçanta dhe të rinjtë ndihen krenar që trashëgojnë e ruajnë traditat më të lashta. “Zona jonë ka traditat më të mira. Ne jemi krenar për këto tradita dhe i përcjellim edhe në brezin e ri”, shprehet një nga vajzat e reja. “Janë tradita shumë të mira”, shprehet një tjetër vajzë. Ndërsa një banor i zonës thotë se këto kostume gjenden vetëm në tre fshatrat e trevës së Matit. Këngët, vallet dhe kostumet shumëngjyrëshe me veçoritë specifike të çdo zone, që do të prezantohen gjatë dy ditëve të këtij panairi, vijnë në Tiranë si një dëshmi e pasurisë shpirtërore të këtyre trevave.



**Muzeu 15 vepra arti do të ekspozohen në Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor në Athinë**

### EKSPOZITA

## Vlera artistike nga fondi i GKA prezantohen në Greqi e Gjermani

Vepra nga fondi i Galerisë Kombëtare të Arteve do të marrin pjesë në një ekspozitë në Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor në Athinë dhe në “Documenta 14” në Kasel të Gjermanisë. Pjesëmarrja e Galerisë Kombëtare të Arteve në këtë ekspozitë realizohet në bashkëpunim me drejtorin artistik të ekspozitës Adam Szymczyk. Kjo pjesëmarrje është e ndarë në dy etapa: 15 vepra arti do të ekspozohen në Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor në Athinë, nga data 8 prill 2017 deri me 16 korrik 2017 dhe 3 (tre) veprat e tjera janë

kërkuar të ekspozohen në Muzeun e Arteve të Bukura “Neue Galerie” në Kasel, nga data 10 qershor 2017 deri me 17 shtator 2017. Artistët që marrin pjesë në “Documenta 14” janë: Abdurrahim Buza (2 punë), Kel Kodheli, Hasan Nallbani, Spiro Kristo (2 punë), Sotir Capo, Arben Basha, Pandi Mele, Zef Shoshi, Gani Strazimiri, Androniqi Zengo Antoniu (3 punë), Foto Stamo, Hasan Reçi, Edi Hila dhe Llambi Blido. Gjithsej janë 18 vepra të 14 autorëve. Pjesëmarrja e veprave të fondit të GKA-së në këtë ekspozitë merr një vlerë të veçantë për shkak

të rëndësisë themelore estetike dhe historike që mbart “Documenta 14” në tërësinë e artit ndërkombëtar. Gjatë 13 edicioneve të mëparshme, “Documenta 14” ka shërbyer si një temë debatesh të kulturës bashkëkohore dhe kontekstit të saj aktual socio-politik, me qëllim adresimin e çështjeve globale, me theks të veçantë në epistemologjitë dhe praktikatat e artit jo-perëndimor. Për shkak të këtij debati, “Documenta 14” ndikon ndryshimin e historisë së artit dhe ripërçakton praktikën ekspozuese bashkëkohore. Koncepti kuratorial i këtij edicioni, i për-

caktuar nga drejtori artistik Adam Szymczyk titullohet “Learning from Athens” [Të mësuarit nga Athina] dhe mëton të ndërtojë një metaforë të distancës mes Athinës dhe Kaselit, që ndryshon themelisht përjetimin e këtij edicioni të ekspozitës nga publiku. Ekspozita do të qëndrojë e hapur përgjatë periudhës 8 prill 2017 deri më 16 korrik 2017 në Athinë (dhe 10 qershor 2017 deri më 17 shtator 2017 në Kasel (Gjermani). Ekspozimi në Athinë bëhet në Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor dhe në Muzeun “Benaki”, në Athinë. Kurator i ekspozitës është Erzen Shkokolli.



# Partizani ngjitet i vetëm në krye të Superiores

Të kuqtë kanë mundur 2-0 Luftëtarin, duke u shkëputur provizorisht 3 pikë nga Kukësi që luan sot

Partizani fiton 2-0 me Luftëtarin dhe kryeson të paktën për një ditë i vetëm renditjen e Superiores me tri pikë më shumë se Kukësi. Nuk kishte ndodhur kurrë më parë në këtë sezon që të kuqtë të linin pas, qoftë për një ditë, rivalët për titull. Një ndeshje jo shumë e vështirë për Partizanin, pasi Luftëtari kapituloi që në pjesën e parë në sfidën e zhvilluar në "Selman Stërmasi". Shtylla e Dejvi Bregut ishte shumë pak për të surprizuar kryeqytetasit, që luajtën për më shumë se një pjesë loje me një lojtar më shumë.

Partizani e nisi në mënyrën më të mirë të mundshme takimin, fillimisht duke rrezikuar me Filin, ndërsa një minutë me vonë Ekuban shpërtheu mes mbrojtjes gjirokastrite dhe rrezohet në zonë, me Jeminin që drejton gishtin nga pika e bardhë e penalltisë. I saktë Batha, përballë Rucit me një goditje qëndrore dhe 1-0. Do të kishte qenë një gol spektakolar për nga mënyra e ekzekutimit, por finalizimi i Bregut në 9' u përplas në shtyllë. Minuta të mira për bluzinjët, por portiere Hoxha reagon gjithmonë në pozicion



pas tentativave të Liçajt dhe Abazajt. I pakujdesshëm Mutumane me dy ndërhyrje të njëpasnjëshme ndaj Bardhit, që ndëshkohen me të verdhë nga Jemini, që detyrimisht i tregon të kuqen mesfushorit nga Mozambiku.

Cetkovic i afrohet golit me një goditje të kalibruar që devijohet nga portieri, ndërsa minutën e 43 Partizani i jep goditjen përfundimtare

Luftëtarit me Ekuban, që përfiton nga kthimi i topit nga Ruci pas goditjes së Krasniqit, duke realizuar të dytin. 2-0 Në pjesën e dytë skuadrat luajnë hapur, të ndikuara nga rezultati por edhe nga inferioritetin numerik i Luftëtarit. Kalari ekzekuton thujse në perfekcion një goditje të lirë nga distanca në të 65-ën, por topi u stampua në traversë. I pafat edhe Bardhi në të 71-ën,

me finalizimin e tij që shkon ngjitur me shtyllën. Starova pas Vilës që mori vendin e Ramadanit, aktivizoi edhe Mazrekajn për Bardhin. Disa minuta në dispozicion edhe për Xhevahir Sukajn, i cili u prit me ovacione nga tifozët e kuq. Goditja e pasaktë e Ekuban në shtesë, shënon rastin e fundit të kësaj sfide, që praktikisht u mbyll që në pjesën e parë.

## KOMBËTARJA E FEMRAVE

# Shqipëria ndalet nga Malta, 0-0 në "Elbasan Arena"

Shqipëria e futbollit të femrave nuk ia del mbanë për të siguruar fitoren e dytë në fazën paraeliminatore të Kampionatit Botëror. Skuadra e Armir Grimës nuk shkoi më shumë se barazimi pa gola ndaj Maltës në ndeshjen e luajtur në "Elbasan Arena". Vajzat kuqezi dominuan përgjatë gjithë 90 minutave, por rastin më të pastër e krijuan kundërshtarët që rrezikuan të shënonin në pjesën e dytë por topi u ndal në transversë. Ndeshja e vlefshme për grupin 2 nisi me topin në këmbë për lojtarët shqiptarë që ushtruan presion në gjysmefushën e maltezeve duke rrezikuar me Velajn që në minutën e 4. Vetëm 3 minuta më pas, Krasniqi kishte në këmbët e saj një top të artë, por sulmuesja shqiptare nuk arriti të finalizonte duke u ndalur



nga portierja malteze. Asnjë sekondë pushim në fushën e lojës sepse Shqipëria kërkoi me çdo kusht golin e parë por nuk arriti ta gjente as me Furtuna Velajn dhe sërish Krasniqin që luftuan edhe

me fatin por nuk ia dolën të shënonin golin që mund të ndryshonte rrjedhën e lojës. 7 minuta nga fundi i pjesës së parë ishte sërish Shqipëria me Morinën por finalizimi i saj me kokë përfundoi jashtë.

Me rikthimin e skuadrave në fushën e lojës, vajzat kuqezi humbën përqendrimin duke mos arritur të ushtrnin të njëjtin presion, duke rrezikuar madje në të 58-ën të pësonin golin e disavantazhit por për fat të mirë ajo goditje u stampua në transversë. Ishte Krasniqi lojtarja më e rrezikshme në zonën malteze por edhe në të 83-ën nuk arriti të kalonte portieren mike Xuereb, ndërsa e njëjta situatë u përsërit edhe disa minuta më vonë ku mesfushorja të shënonte. Shqipëria ishte shumë pranë avantazhit edhe në të 88-ën por Xuereb shpëtoi portën e Maltës. E pafat Shqipëria në këtë sfidë ku mori vetëm një pikë dhe tashmë ndjek Greqinë me pikë të plota. Në duelin e tretë të grupit, vajzat kuqezi janë të detyruara të fitojnë për t'u kualifikuar në fazën eliminatore.

## Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

### LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- VD/Trafikantët me kanabis arrati në mal, policia i zë në pritë
- Vettingu, Meta: Më 11 Prill seancë e jashtëzakonshme PD: S'vijmë!
- Tërmet 5.2 ballë në Mirditë dridhet Tirana, Durrësi, Shkodra
- Keni probleme me mushkëritë? Disa hapa për ti pastruar brenda 72 orëve
- Ambasadorja gjermane ia merr labçenë në jug të Shqipërisë/VD
- Rama: Ura e Bunës e harruar nga Voltana. Kryebashkiakja: Autogol!
- Erë përplasjesh, Kremlini mesazh SHBA-së: Një hap larg nga lufta
- Tefta Radi: Cfarë ndodhi me Frankon pak ditë para se të shuhej
- Nga Bernd Fisher/Një letër nga SHBA për Bashën e Xhelal Mziun
- Luftanijet ruse u afrohen luftanijeve amerikane që lëshuan 59 raketat

### LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Vettingu, Meta: Më 11 Prill seancë e jashtëzakonshme PD: S'vijmë!
- Dialogu, 38 propozimet që ndajnë PS, PD, PDIU dhe LSI
- Basha: Jo reformës 'alla Shullazi' Vettingu pas zgjedhjeve!
- Rama: Ura e Bunës e harruar nga Voltana. Kryebashkiakja: Autogol!
- Rama ironizon: Qeveria? Po kur thonë nuk është çështje karrigesh

### VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE



Gjinushi: Pas qeverisë së besimit fshihet qeveri kulisash PD-LSI




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

## SONDAZH I DITES

Sipas jush, është e pranueshme të realizohen zgjedhje politike në Shqipëri pa pjesëmarrjen e opozitës?

### Rezultati i Sondazhit



#### SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.815 | 327 492  
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE



FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

17x17 crossword grid for 'Fjalëkryqi pa skemë'.

HORIZONTAL

- 1. Film i Barry Primus. -Janë njerëzit e gjallë. 2. Klikohen me mouse...

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Word search grid for 'Fjalëkryqi pa skemë'.

VERTIKAL

- 1. Kthente në ar çdo gjë që prekte. -Janë besimtarë. 2. Janë meduza...

FJALËKRYQI SPORTIV

17x17 sports-themed crossword grid.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Word search grid for 'Fjalëkryqi sportiv'.

HORIZONTAL

- 1. Sandro te Juventus. 4. Pak amatoriale. 7. Është numri 3...

SUDOKU

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

PËRGJIGJE

9x9 Sudoku grid.

9x9 Sudoku grid.

HOROSKOPI

DASHI

Partneri do jene gjate gjithë kohës ne anën tuaj sot dhe do mundohet me sa te mundet t'ua plotësojë te gjitha dëshirat.

DEMI

Jetës tuaj ne çift nuk do i mungojnë momentet interesante sot. Për asnjë moment nuk do qëndroni ne heshtje me partnerin tuaj.

BINJAKËT

Dite e ndryshme nga ato qe keni kaluar kohet e fundit ju te dashuruarit. Marrëdhënia me partnerin do jete e veçante dhe do zbuloni edhe disa ane te reja te tij qe do ju bëjnë ta adhuroni akoma me shume.

GAFORRJA

Edhe pse presioni nga jashtë do jete shume i madh gjate kësaj dite, ju nuk do i dëgjoni aspak te tjerët dhe do bëni gjithçka qe dëshironi.

LUANI

Dite e shkëlqyer do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Gjate gjithë kohës do përjetoni emocione te forta dhe do i harroni problemet qe keni pasur me herët.

VIRGJËRESHA

Dite shume e tensionuar do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Gjate gjithë kohës do keni debate te forta me partnerin dhe nuk do ndiheni mire për asnjë çast.

PESHORJA

Dite aspak e qete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Ne shume momente do debatoni ashpër me atë qe keni ne krah dhe do mërziteni.

AKREPI

Nuk do silleni aspak mire me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe kjo mund te sjelle probleme e debate ndërmjet jush.

SHIGJETARI

Sot do përballeni me surpriza te jashtëzakonshme ju te dashuruarit. Çdo çast i kaluar pranë partnerit do jete aq i bukur saqë shpesh do ju duket vetja si neper ëndrra.

BRICJAPI

Orët e para te mëngjesit nuk do jene shume te mira për jetën tuaj ne çift sot, por me kalimin e kohës situata do filloje te normalizohet.

UJORI

Juve qe jeni ne një lidhje sot do ju pëlqejnë gjerat e çmendura dhe mund te ndërmerrni edhe rreziqe vetëm për te përjetuar sa me shume emocione.

PESHQIT

Kujdes me autoritetin e tepruar sot ju te dashuruarit sepse kjo gjë mund te sjelle probleme serioze ne çift.

PËRGJIGJE

Word search grid for 'Shkronja e njëjtë për numër të njëjtë'.

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

17x17 cryptogram crossword grid.



# NA VIZITONI



# BUNK'ART 2

EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BRENDIA ISH-BUNKERIT  
ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME

[www.bunkart.al](http://www.bunkart.al) / [info@bunkart.al](mailto:info@bunkart.al)

**HAPUR ÇDO DITË:  
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:  
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"  
PRANË MINISTRISË  
SË BRENDSHME-TIRANË**

